



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në:**

**“Teknologji Automobilah”**

**“Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Alketa Grepcka**

**Dr. Gazment Qatipi**

**Nëntor / 2023**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Programi i studimit me karakter profesional në “Teknologji Automobilah”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimi me karakter profesional në “Teknologji Automobilah”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë e MASH Nr. 2502 Prot, datë 13.04.2007
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Programi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë, përshtatjen e programit me Vendim Senati Nr. 87, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresën Nr. 7239/1, datë 17.08.2018, si dhe riorganizuar deri në 20 % me Vendim Senati Nr. 19, datë 28.03.2022, konfirmuar nga MASR me shkresën Nr. 2085/1 Prot., datë 27.06.2022, ndryshime të cilat hyjnë në fuqi në vitin akademik 2022-2023
6	Urdhëri për regjistrimin e Formës së diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 324, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	-
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite ( 4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i KSHK
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve për dy vitet e fundit 2020-2023):	2021 – 2022 59 studentë 2022 - 2023 69 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Licensimi programit është bërë me: Shkresë të MASH Nr. 2502 Prot, datë 13.04.2007 (për hapjen e degës “Mekanike” dhe në fund lëshohet diploma “Teknologji Automobilash”).

Programi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë, duke bërë përshtatjen e programit me legjislacionin e ri, me Vendim Senati Nr. 87, datë 14.06.2018. Ky riorganizim është miratuar nga MASR, me shkresën Nr. 7239/1, datë 17.08.2018.

Gjithashtu programi është riorganizuar (më pak se 20 %) me Vendim Senati Nr. 19, datë 28.03.2022, dhe është konfirmuar nga MASR me shkresën Nr. 2085/1 Prot., datë 27.06.2022. Në këtë shkresë përcaktohet se ndryshimet hyjnë në fuqi në vitin akademik 2022-2023.

Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë (më tej DSHID)

Njësia Kryesore në të cilën bën pjesë DISHD është Fakulteti i Studimeve Profesionale (më tej FSP).

Regjistrimi i formës së diplomës është bërë me Urdhër të MASR Nr. 324, datë 22.10.2020.

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në “Teknologji Automobilash” realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Diplomë Profesionale” në “Teknologji Automobilash”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në tre fundit (2020-2023) 180 studentë

UAMD ka aplikuar në ASCAL më datë 24.01.2022 (Shkresë e IAL Nr. 121 Prot, datë 21.01.2022), për akreditimin e parë të këtij programi.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (më tej RVB), dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që ai kreu në institucion në datat 3-4 Korrik 2023. Gjithashtu ai mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Brendshme të sigurimit të Cilësisë, së Kurrikulës, etj.

Në bazë të vlerësimit të jashtëm janë: Ligji Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, disa elementë të Ligjit për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve nr. 10247/2010, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave të sjella nga UAMD në DVV, dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në vend. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që mbulojnë, sigurimit të cilësisë, etj. Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Majlinda Demirmeli.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 20.09.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 15/151 Prot, datë 20.09.2023. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës më datë 17.10.2023, njofton, me anë të shkresës me Nr.18/24 Prot, datë 16.10.2023 “*Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit*”, ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji Automobilash”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	GVJ gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, nga informacioni i marrë në DVV, nga takimet e zhvilluara me të gjithë faktorët dhe aktorët, por edhe nga njohjet e tij mendon se misioni i UAMD dhe programi i studimit TA është në përputhje me interesat Kombëtare dhe është konsoliduar kontributi i tij në ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Nga “Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025” shkëpusim:  <i>UAMD, ka si mision të kryej mandatin e tij arsimor dhe shkencor në mënyrë të kënaqshme dhe në hap me kohën, të promovojë Arsimin e Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke gjeneruar ide të reja dhe moderne, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim shkencor.</i>  Ref: RVB - program 2-vjeçar TA_Elëvishka_17.03.2023.pdf Ref: 17_Statuti UAMD + Urdher M. SR_385, 09.07.2019.pdf Ref: 15_Plani i zhvillimit strategjik UAMD 2020-2025.pdf
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ mendon se e vecanta, që është kthyer në një traditë shumë të suksesshme në UAMD janë programet e studimit profesionale 2 vjecare të Nivelit 5 të KSHK, të cilat janë mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e përgjithshëm, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Edhe programi 2 vjecar me karakter profesional “Teknologji Automobilash” e përmbush këtë kriter më së miri. Për këtë përfundim GVJ u mbështet në analizën e të gjitha akteve akademike dhe ligjore të hartimit, zbatimit, riorganizimit të këtij programi studimi.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike	Nga leximi i dokumentave si: “Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025”, “Rregullore e Programit të studimit 2019”, Organigramën e UAMD, etj, GVJ mendon se programi i Studimit TA është në përputhje me kërkesat e këtyre dokumentave, si dhe ka përputhje me fushat që mbulohen nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë. Mendojmë

të tij.	se strategjia për të ofruar programe të tilla 2 vjecare inxhinierike, i shërben shumë mirë ekonomisë lokale dhe kombëtare. <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Programi është licencuar në vitin 2007 dhe në rreth 17 vite të zhvillimit të tij ka treguar se kërkohet nga tregu lokal dhe kombëtar i punës. Nga intervistat me studentët GVJ konstatoi se Institucioni ka arritur të integrojë diplomën e lëshuar në këtë program studimi me marrjen e licencës për hapjen/drejtimin e Oficines për shërbimin ndaj automobilave  <i>Ref: Shënime nga intervista me studentë</i> <i>Ref: 20_Profesion kerkuara-Fondacioni Friedrich Ebert 2015.pdf</i> <i>Ref: 56_Raporti-i-Tregut-të-Punës-Final, 2017.pdf</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga tabela e të dhënave për stafin akademik që realizon kurrikulën e programit të studimit, rezulton se në vitet akademike 2016-2023 janë përfshirë personel akademik i kualifikuar, i përshtatshëm për lëndët që kanë mbuluar. Në të gjitha vitet personeli akademik ka qenë me kualifikimin Msc, përveç 1-2 pedagogëve që kanë gradën Dr.  Nga CV e personelit akademik GVJ konstatojnë se secili prej tyre ka eksperiencë, kapacitete për ofrimin e programit të studimit. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se FSP ka burimet e duhura (auditorë/laboratorë, bibliotekë, mjete didaktike, etj), të cilat janë në shërbim të programit që ofron FSP. Ndërkohë mendojmë se Qyteti i Durrësit ka burimet e duhura (Porti, Drejtoria hekurudhore, kompani transporti etj), që mund të shërbejnë si uditor për kryerjen e praktikave profesionale, por që gjithashtu kanë nevojë për studentët e diplomuar, që e bëjnë shumë të nevojshëm këtë program studimi.  <i>Ref: RVB - program 2-vjeçar TA_Eli Vyshka_17.03.2023.pdf</i> <i>Ref: Tabelat 1-12_TA.pdf_vule.pdf</i> <i>Ref: Tabela 16 - Ambientet e FSP ++.pdf</i> <i>Ref: Tabela 17 - Biblioteka ++.pdf</i> <i>Ref: 96_Tabela laborator - prog studimi.pdf</i> <i>Ref: 93_Planimetri + kapac. infrastr Currila + Kampus 1 - 2022.pdf</i>
<b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve	GVJ mendon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit TA është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit – DSHID. Mbështetur në dokumentin <i>49_Kodifikimi programeve-praktika shkresore-v. 2022.pdf</i> , rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TA, mbështetur në VKM 310/2022.

kombëtare e evropiane.	<p>Kodi i këtij programi është <b>S-52-PP-0716</b></p> <p>Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf  Ref: 22_Personeli DSID - te dhena + kualifikim.pdf  Ref: 23_Cilësi stafi për program_TA_2016-2023.pdf  Ref: 24_Dosje personale pedagog TA_2022.pdf  Ref: 25_C-V pedagog të programit TA - 2023.pdf  Ref: 28_Rregullore programi TA 2019.pdf</p>
------------------------	--

**Konkluzione:**

UAMD ofron programin e studimit me karakter profesional, 2 vjecar, "Teknologji Automobilash", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TA, mbështetur në VKM 310/2022. Kodi i këtij programi është **S-52-PP-0716**

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

**Standardi I.2**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se FSP dhe DSHID kanë realizuar bashkëpunime me departamente të tjera për angazhimin e pedagogëve që mbulojnë lëndët e programit të studimit. Lëndë të tilla si <i>Matematika, Anglisht, Fizika, Teknika e komunikimit</i>, mbulohen nga departamente të tjera të UAMD, duke realizuar harmonizimin midis strukturave akademike, pa pengesa dhe në të mirë të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ mendon se duhet përmirësuar edhe më tej bashkëpunimi ndër-departamentor, për ndonjë përmirësim të syllabuseve përkatëse, më të përshtatshme/përputhshme me kurrikulën e programit të studimit dhe objektivave të saj.</i></p> <p>Në RVB janë deklaruar dy marrëveshje me stafin akademik përkatës, por që mungojnë në DVV.</p> <p>Ref: 97_Marrëveshje FSP dhe FTI_21.04.2020.pdf</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p><i>Ref: 60_Syllabuset_Teknologji Automobilahsh_2021-2022.pdf</i></p> <p>Nga të dhënat që referohen në RVB, nga dokumentat në DVV si dhe takimet në vizitë, GVJ konstaton se UAMD, DSHID, etj kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, me institucione homologe, si: Universitetin “I. Qemali” të Vlorës, Universitetin “Luarasi”, Kolegjin Profesional të Tiranës, etj. Këto bashkëpunime përfshijnë si synimet për shkëmbime stafi, shkëmbime eksperiencash mësimdhënëse ashtu edhe për këmbime studentësh.</p> <p>Gjithashtu UAMD ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me biznese të rëndësishme në Durrës dhe më gjërë. Programi i studimit AT është përfshirë në disa marrëveshje si më poshtë:</p> <p><i>Ref: 33_Marreveshje UAMD me APD 30.01.2018.pdf</i>  <i>Ref: 35_Marreveshje FSP me Adria Ferries 26.06.2016.pdf</i>  <i>Ref: 37_Marreveshje FSP me Shega Trans, 07.05.2018.pdf (me afat 4 vjecar nuk është rinovuar)</i>  <i>Ref: 38_Marreveshje FSP-Auto Star Albania 2017+2022+Kadiu 2022.pdf me afat 2017-2019), nuk është rinovuar</i>  <i>Ref: 39_Marreveshje UAMD me Logistic Diamant 30.08.2018.pdf</i>  <i>Ref: 31_Marreveshje FSP me U Vlore+Luarasi+Kolegji prof. TR.pdf</i>  <i>Ref: Tabela 20 - Bashkëpunim komb+ndërk..._DSID_2023.pdf</i></p> <p>GVJ mendon se këto marrëveshje janë të përshtatshme për realizimin e objektivave të procesit mësimor. (Më lart nuk janë cituar marrëveshjet e UAMD, që nuk kanë lidhje me programin e studimit).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Sic u citua edhe më lart UAMD, si dhe FSP kanë synuar realizimin e marrëveshjeve të përbashkëta me kompani prodhuese ose shërbimi për të realizuar praktikat profesionale të studentëve. Marrëveshjet në përgjithësi janë afatgjata (4-5 vjecare) me të drejtë rinovimi. UAMD mendojmë se duhet të bëjë rinovimin e tyre, duke qenë se janë marrëveshje të qëndrueshme.</p> <p><i>GVJ sugjeron, që marrëveshjet e bashkëpunimit mund të zgjerohen edhe me ofcinat e shërbimit të automjeteve, ku ish studentët (alumni) janë punësuar aktualisht, ose me ofcina të tjera që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale.</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në RVB është deklaruar që DSHID harton raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me punëdhënësit në funksion të realizimit të programit të studimit. Në DVV janë vendosur raportet vjetore të analizës së punës së departamentit, për vitet 2020-2021 dhe 2019-2020 (mungon raporti i vitit 2021-2022) dhe në këto raporte është analizuar edhe praktika mësimore dhe bashkëpunimi me kompani të ndryshme. Por referuar kriterit majtas dhe dokumentacionit në DVV, nuk ka raport analitik <u>të vecantë</u>, të përfitimeve nga marrëveshjet e nëshkruara.</p> <p><i>GVJ, sugjeron që këto analiza të realizohen në formën e raporteve të shkruara vjetore, ku të analizohet më me hollësi se çfarë shkoi mirë dhe çfarë duhet të përmirësohet në këto bashkëpunime.</i></p> <p><i>Ref: 83_Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se në RVB është deklaruar se UAMD/FSP ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. GVJ takoi përfaqësues të sektorit të Karrierës, Alumni dhe Komunikimit, të cilët treguan se kishin marrë disa iniciativa si aktivitete promovimi, takime me alumni të suksesshëm, etj, që nxisin punësimin e studentëve të diplomuar. Gjithashtu GVJ konstatoi se studentët e intervistuar ishin të punësuar në biznese familjare, ose lokale.</p>

**Konkluzione:**

*GVJ konstaton se UAMD/FSP kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, etj.*

*GVJ sugjeron që: UAMD duhet të bëjë rinovimin e Marrëveshjeve që janë në përfundim të afateve, etj, duke qenë se janë marrëveshje të qëndrueshme.*

*Marrëveshjet e bashkëpunimit mund të zgjerohen edhe me ofcinat e shërbimit të automjeteve, ku studentët janë punësuar pas diplomimit, që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale.*

*GVJ sugjeron që analizat për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit të realizohen edhe formën e raporteve të shkruara vjetore.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

**Standardi L3**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të**

posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e DVV, GVJ konstaton se UAMD/FSP kanë struktura të ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Strukturat përgjegjëse Institucionale deklarohen në organigramë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) me dy sektorët;</li> </ul> <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti);</li> <li>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (Bch/MP/ Msc).;</li> <li>Koordinatorët e Programeve (Bch/MP/Msc);</li> </ul> <p>Politika e sigurimit të brendshëm të cilësisë bazohet në Rregulloren për Sigurimin e Cilesise, ndërsa procedurat shtrihen në të gjithë veprimtarinë menaxheriale dhe akademike.</p> <p><i>Ref: 41_Politikat hapje, riorg program stud + Vendim SA_15/2021.pdf</i>  <i>Ref: 42_Organiograma + struktura analitike e UAMD.pdf</i>  <i>Ref: 43_Organiograma + struktura FSP - 2023.pdf</i>  <i>Ref: 44_Rregullore per Sigurimin e Cilesise + VSA_13/2023.pdf</i>  <i>Ref: 45_Njesia Sigurim Cilesise FSP me V Dekanati_10/2021.pdf</i>  <i>Ref: 46_Koordinatorët-Vendim DSID 1/2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga DVV, RVB dhe vizita në institucion u konstatua që në UAMD janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e Sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në Nenin 6 të Rregullores së Cilësisë është sanksionuar që:</p> <p><b>Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie</b> sigurohet nëpërmjet: a) Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, b) Vlerësimit të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë</p> <p><b>Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD)</b> sigurohet nëpërmjet: a) Pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin; b) Pyetësorit të stafit akademik, i cili</p>

	<p>vlerëson institucionin; c) Pyetësofit të stafit administrativ, i cili vlerëson institucionin; d) Vlerësimin të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin administrativ që ai drejton.</p> <p><b>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit</b> sigurohet nëpërmjet: a) përcaktimit të kriterëve dhe afatëve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, duke u bazuar në modelet e brendshme të UAMD; b) standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit siç përcaktohen në kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë; c) rregullores së studimeve për çdo program; d) cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin; e) politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore; f) infrastrukturës mësimore; g) ndërkombëtarizimit të programeve; h) monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.</p> <p><b>Vlerësimi i cilësisë së studentëve</b> sigurohet nëpërmjet: a) kriterëve të pranimit duke respektuar karakteristikat e programit të studimit; b) kriterëve të vlerësimit të studentëve; c) kriterëve të vlerësimit të punimeve të diplomave; d) treguesve të rezultateve të të nxënësve; e) treguesve të shërbimeve mbështetëse për studentët; f) treguesve të punësimit të të diplomuarve; g) mbështetjes së mobilitetit të studentëve; h) njohjes së studimeve.</p> <p><b>Vlerësimi i cilësisë së personelit</b> sigurohet nëpërmjet: a) kriterëve të rekrutimit; b) përshkrimit standart dhe specifik të punës; c) treguesve të performancës nga vlerësimi i studentëve dhe eprorit; d) vlerësimit të performancës nga eprori; e) mbështetjes së mobilitetit; f) standardeve të promovimit; g) nivelit të trajnimit.</p> <p><b>Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor</b> sigurohet nëpërmjet: a) planit strategjik të kërkimit shkencor; b) procedurës së monitorimit të treguesve dhe të vlerësimit të kërkimit shkencor; c) sistemit të informimit për kërkimin shkencor. GVJ gjatë vizitës në UAMD i preku të gjithë këto elementë për programin TA.</p> <p><i>Ref: 44_Rregullore për Sigurimin e Cilësisë + VSA_13/2023.pdf</i>  <i>Ref: 47_Formular vlerësimi të pedagog nga stud - CleanScore.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i</p>	<p>Në rregulloren për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar (shih më lart) treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë Përsa i përket vlerësimit të jashtëm, UAMD ka realizuar akreditimin</p>

jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	institucional që nga viti 2016 e në vijim. Aktualisht me VBA nr. 18, date 24.03.2022, ka akreditim të vlefshëm deri në vitin 2026. Ndërsa programi TA akreditohet për herë të parë <i>Ref: 44_Rregullore per Sigurimin e Cilesise + VSA_13/2023.pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	GVJ konstaton se kriteret e cituara në Nenin 6 të Rregullores së Cilësisë janë tregues të matshëm të cilësisë.  Ndërsa treguesit e matshëm në mësimdhënie dhe kërkim jepen në Aneksin II të rregullores.  <i>Ref: 44_Rregullore per Sigurimin e Cilesise + VSA_13/2023.pdf</i>

**Konkluzione:**

*UAMD ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme, për sigurimin e cilësisë së Institucionit dhe të programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.*

*Institucioni përdor tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL**

<b>Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>

**Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

GVJ mbështetur në dokumentacione DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji Automobilah” është i organizuar në lëndë/module dhe aktivitete formuese, leksione, ushtrime, laboratore, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite (ECTS) në total. Kategoritë e veprimtarive formuese janë në përputhje me VKM 879/ 2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41/2018”, Tabela 1.1:

- ✓ Kategoria A-Lëndë Bazë 15%; **gjithsej 3 lëndë**
- ✓ Kategoria B-Lëndë karakterizuese 53.34%; **gjithsej 8 lëndë**
- ✓ Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/ integruese/GRUP-LËNDË ME ZGJEDHJE 13.33%; **gjithsej 4 lëndë/module**, ku studenti mund të zgjedhë 2 prej tyre
- ✓ Kategoria D-Lëndë plotësuese 13.33%; **gjithsej 2 lëndë**
- ✓ Kategoria E-Detyrime përmbyllëse 5%, - **Provim përmbyllës**

Plani mësimor 2022-2023 ka të gjithë elementët e duhur në përputhje me legjislacionin shqiptar. GVJ konstaton se në përgjithësi është bërë një punë e mirë për hartimin e kurrikulës.

*Ref: 49\_Kodifikimi programeve - praktika shkresore-v. 2022.pdf*

*Ref: 50\_Shtojca 1 Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf*

*Ref: 51\_Diploma+suplementi TA + memo.pdf*

*Ref: 52\_Vendim SA+kurrikula TA\_19, 28.03.2022\_riorg 20%.pdf*

*Ref: 53\_VKM 165/2021+VKM 879/2019+VKM 41/2018.pdf*

*Ref: 54\_Udhezime MASR\_7/2021+1/2020+31/2017.pdf*

*Ref: 55\_Plani mesimor + veprimtari (A+E) TA\_2018-2020.pdf*

*Ref: Tabelat 1-12\_TA\_pdf\_vule.pdf*

**Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.

GVJ në disa dokumenta të DVV ka gjetur se cilat janë njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë programin e studimit TA. Konkretisht në *Shtojca 1 Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf*, [cit]:

*Programi i Studimit 2-vjeçar, Diplomë Profesionale në “Teknologji Automobilah” ofron një drejtim të rëndësishëm për të cilin ka shumë nevojë, për specialistë të aftë në fushën automjeteve, të shërbimeve dhe sigurisë së transporteve rrugore. Kuadri formues për këtë specialitet synon të aftësojë dhe edukojë profesionistë të ardhshëm në fushën e automjeteve, duke studjuar në detaje mekanizmat dhe sistemet e automjetit, problemet me defektet më frekvente që hasen në të gjitha nyjet dhe detalet e automjetit. Studenti njihet nga afër me skemat kinematike të funksionimit të nyjeve kryesore të automjetit,*

	<p><i>diagnostikimin e hershëm dhe shërbimet teknike të domosdoshme për jetëgjatësinë dhe sigurinë e automjetit, si në “Laboratorin e Teknologjisë së Automjetit” që ndodhet në ambientet e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, ashtu dhe në praktikat profesionale në qendrat e njohura të asistencës teknike në vend siç është “Auto-Star Albania” duke u aftësuar dhe orientuar drejt teknikisht.</i></p> <p>Në RVB është deklaruar se ky program përgatit specialistë me aftësi praktike-teknike për automjetet rrugore, duke përfshirë mësimet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Teknologji dhe dizajn në nivel produkti dhe komponenti;</li> <li>▪ Njohuri mbi ndërtimin dhe materialet;</li> <li>▪ Parimet dhe sistemet elektrike dhe elektronike të mjeteve;</li> <li>▪ Sistemet e lëvizjes dhe dinamikën e automjeteve;</li> <li>▪ Sistemet e IT si mjete për zgjidhjen e problemeve dhe diagnozës;</li> <li>▪ Shitjet dhe shërbimin duke u fokusuar në kujdesin ndaj klientit, që lehtësojnë punësimin e tyre në sektorin e transportit rrugor;</li> </ul> <p><i>Ref: 50_Shtojca 1 Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p><i>Në Rregullore programi_TA 2019.pdf, [cit]:</i></p> <p>Programi i studimit 2-vjeçar, Diplomë Profesionale në “Teknologji Automobilash” ka për mision:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. T’u ofrojë studentëve mundësinë që të thellojnë dhe zhvillojnë dijet si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën e teknologjisë së automobilave;</i></li> <li><i>2. Të pregatisë studentët që të menaxhojnë, administrojnë dhe të koordinojnë rrjetin dhe sistemet e transportit;</i></li> <li><i>3. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e ekspertizës së pjesëve të këmbimit të autoveturave;</i></li> </ol> <p>Objektivat kryesore formuese të programit të studimit 2-vjeçar, Diplomë Profesionale në “Teknologji Automobilash” janë:</p> <p><i>a) Përgatitja e specialistëve me kualifikim sa më bashkëkohor në fushën e teknologjisë së automobilave dhe të mjeteve të transportit rrugor; pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor dhe të riparimeve, në sektorin publik e privat.</i></p>

	<p>b) Të përgatisë specialistë me kualifikim sa më bashkëkohor të njohurive teknike specifike për Drejtues teknik, menaxher, dispeçer për parqet e automjeteve të transportit të mallrave dhe të pasagjerëve (të brendshëm dhe ndërkombëtar) dhe pikave të tregëtimit të pjesëve të këmbimit për automjetet.</p> <p>c) Përgatitja e specialistëve në fushën e shërbimeve të automjeteve, në fushën e riparimeve të automjeteve, të asistentit teknik, të kolaudatorit dhe kontrollorit teknik pranë Qendrave të Kontrollit Teknik, apo në autosallonet dhe serviset e autorizuar, asistent menaxhere në autosallone të autoveturave dhe analistëve të aftë në ofrimin e ekspertizës në vlerësimin e indikatorëve teknike e menaxheriale të fushave të transporteve rrugor.</p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf</p>										
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit 2-vjeçar Diplomë Profesionale në “Teknologji Automobilash” referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Diplomë Profesionale” në “Teknologji Automobilash” në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacione DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Teknologji Automobilash” ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kohëzgjatja normale 2 vite/120 kredite;</li> <li>• 1 vit akademik ka 60 kredite/30 javë mësimore;</li> <li>• 1 semestër ka 15 javë mësimore;</li> <li>• 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit;</li> <li>• 1 orë mësimore = 50' minuta;</li> </ul> <p>Të gjitha lëndët/modulet janë të shprehura në kredite që janë nga 4-8 kredite. Kategoritë e veprimtarive formuese kanë:</p> <table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td>• Kategoria A-Lëndë Bazë</td> <td style="text-align: right;"><b>18 ECTS</b></td> </tr> <tr> <td>• Kategoria B-Lëndë karakterizuese</td> <td style="text-align: right;"><b>64 ECTS</b></td> </tr> <tr> <td>• Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/ integruese/GRUP-LËNDË ME ZGJEDHJE</td> <td style="text-align: right;"><b>16 ECTS</b></td> </tr> <tr> <td>• Kategoria D-Lëndë plotësuese</td> <td style="text-align: right;"><b>16 ECTS</b></td> </tr> <tr> <td>• Kategoria E-Detyrime përmbyllëse</td> <td style="text-align: right;"><b>6 ECTS</b></td> </tr> </table>	• Kategoria A-Lëndë Bazë	<b>18 ECTS</b>	• Kategoria B-Lëndë karakterizuese	<b>64 ECTS</b>	• Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/ integruese/GRUP-LËNDË ME ZGJEDHJE	<b>16 ECTS</b>	• Kategoria D-Lëndë plotësuese	<b>16 ECTS</b>	• Kategoria E-Detyrime përmbyllëse	<b>6 ECTS</b>
• Kategoria A-Lëndë Bazë	<b>18 ECTS</b>										
• Kategoria B-Lëndë karakterizuese	<b>64 ECTS</b>										
• Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/ integruese/GRUP-LËNDË ME ZGJEDHJE	<b>16 ECTS</b>										
• Kategoria D-Lëndë plotësuese	<b>16 ECTS</b>										
• Kategoria E-Detyrime përmbyllëse	<b>6 ECTS</b>										

	<p>Në program janë parashikuar kredite për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione <span style="float: right;">52 ECTS</span></li> <li>• Ushtrime/ <span style="float: right;">3.5 ECTS</span></li> <li>• Seminare <span style="float: right;">29.5 ECTS</span></li> <li>• Laboratorë <span style="float: right;">1 ECTS</span></li> <li>• Orë për kontrollin e vazhdueshëm <span style="float: right;">5 ECTS</span></li> <li>• Praktikë profesionale <span style="float: right;">16 ECTS</span></li> <li>• Projekt detyra <span style="float: right;">7 ECTS</span></li> <li>• Provim përfundimtar <span style="float: right;">6 ECTS</span></li> </ul> <p><i>Ref: 49_Kodifikimi programeve - praktika shkresore - v. 2022.pdf</i>  <i>Ref: 50_Shtojca I Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf</i>  <i>Ref: 51_Diploma+suplementi TA + memo.pdf</i>  <i>Ref: 52_Vendim SA + kurrikula TA_19, 28.03.2022_riorg 20%.pdf</i>  <i>Ref: 53_VKM 165/2021+VKM 879/2019+VKM 41/2018.pdf</i>  <i>Ref: 54_Udhezime MASR_7/2021+1/2020+31/2017.pdf</i>  <i>Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf</i>  <i>Ref: Tabelat 1-12 TA pdf_vule.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD nuk gëzon status të veçantë</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ nuk gjeti dokumentacion referues që të shprehet për këtë kriter. Në dosje është attach-uar një kurrikulë e ngjashme (plan program dhe syllabuse të përmbledhura), që ofrohet në një kolegji në SHBA.</p> <p><i>GVJ sugjeron, se FSP duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, pra të shprehet për programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi në Shqipëri/Europë dhe më gjerë. Gjithashtu sugjerohet të rishihen edhe programet lëndore të tyre, për të përafëruar kurrikulën dhe për të realizuar kriterin majtas.</i></p> <p><i>Ref: 63_Kurrikula Automotive and Diesel Institute New York.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës,</p>	<p>Sic GVJ ka shkruar më lart, rezulton se është bërë edhe</p>



<p>sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TA, mbështetur në VKM 310/2022.</p> <p>Kodi i këtij programi është <b>S-52-PP-0716</b>. Për kodifikimin e lëndëve në RVB është ky informacion:</p> <p><i>Në mungesë të legjislacionit për kodifikimin e lëndëve të programit, ky kodifikim është bërë sipas përvojës personale të Koordinatorit të këtij programi duke ruajtur kod të njëjtë të lëndëve të programeve të tjera të ofruara nga DSID dhe të dhënave të kodeve të marra nga interneti.</i></p> <p>Ref: 49_Kodifikimi programeve - praktika shkresore - v. 2022.pdf</p>
---	---

**Konkluzione:**

GVJ konstaton se Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Bolonjës, ku lëndët modulet janë shprehur në kredite/orë për kredite. Lëndët janë organizuar në disa forma mësimdhënie si: Leksione, Ushtrime, Seminare, Laboratore, Praktikë profesionale etj. GVJ sugjeron, rishikimin e sasisë së orëve në auditor në praktikat profesionale dhe në ndonjë lëndë tjetër.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

**Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi						
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>GVJ për vlerësimin e këtij kriteri ju referua të dhënave tabelore të deklaruara në DVV, nga të cilat rezultoi se, Njësia kryesore FSP përmbush kërkesat ligjore për të patur në organizimin e saj të paktën 3 departamente. Ajo ka në përbërjen e saj 4 Departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë;</li> <li>• Departamenti i studimeve të Integruara me Praktikën;</li> <li>• Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore;</li> <li>• Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës;</li> </ul> <p>Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detare, ka këto të dhëna:</p> <table border="1" data-bbox="639 1944 1422 1986"> <thead> <tr> <th>Tituj /grada</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Tituj /grada	2021-2022	2022-2023			
Tituj /grada	2021-2022	2022-2023					

	PAE	PAK	Gj	PAE	PAK	GJ
Prof.Dr	0	1	1	0	1	1
Prof.As.	1	0	1	1	0	1
Dr/Phd	4	4	8	4	4	8
Dr në proces	1	0	1	1	0	1
Msc	8	25	33	8	25	33
P/ ndihmës akademik	2	0	2	2	0	2
<b>Në total</b>	<b>16</b>	<b>30</b>	<b>46</b>	<b>16</b>	<b>30</b>	<b>46</b>

Pra njësia bazë plotëson kriterin e numrit total se ka në përbërje numrin minimal të kriterit ligjor, dhe plotëson numrin minimal të PAE që kanë tituj/grada sepse ka vetëm 4 PAE me gradën Dr

**Shënim:** Në RVB citohet dokumenti 21 dhe 22 (me të cilat është ndërtuar tabela më sipër, por në disa dokumente të tjerë në DVV, si Tabelat përmbledhëse (Tabela 1-12) të cilat janë edhe me vulë zyrtare, kanë të dhëna komplet të tjerat nga ku del se kërkesat ligjore nuk plotësohen se rezulton vetëm 1(një) PAE me gradën Dr.

Ref: 21\_Personeli 4 Departamentet e FSP - 2023+pdf

Ref: 22\_Personeli DSID - te dhena + kualifikim.pdf

Ref: Tabela 1 - Personeli \_TA v. 2023.pdf

Ref: Tabelat 1-12 TA pdf\_vule.pdf

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

GVJ konstaton se në departament janë 2 (dy) personell ndihmës akademik në DSHID.

*Mendojmë se me 10 programe studimi që ofron ky departament (1 Bsc/1 MP/8 PP) dhe me numrin total të studentëve që është i konsiderueshëm, duhet të jetë më i madh numri i PVM shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punëve në departament, organizimin e laboratorëve, etj.*

Ref: Tabela 1 - Personeli \_TA v. 2023.pdf

Ref: Tabelat 1-12 TA pdf\_vule.pdf

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

GVJ konstaton se koordinatori i programit, sipas rregullores së programit të studimit, ka rol kyç në sigurimin e cilësisë së studimeve në programin e studimit. Koordinatori i Programit të studimit ka këto detyra dhe përgjegjësi (Neni 12):

a) Raporton pranë Dekanit dhe NjBSC mbi ecurinë dhe standardet e programit;

b) Përgatit raporte vjetore për vlerësimin e brendshëm të programit të studimit 2-vjeçar;

c) Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut;

d) Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e

	<p>programit e studimit 2-vjeçar, Diplomë Profesionale në “Teknologji Automobilash”;</p> <p>e) Koordinon punën për mbledhjen e programeve lëndore (syllabuset);</p> <p>f) Përgatit një raport vjetor, si dhe kur kërkohet nga NjBSC gjatë një procesi akreditimi, mbi veprimtarinë kërkimoreshkencore;</p> <p>g) Kujdeset për ecurinë dhe zhvillimin e Praktikave Profesionale;</p> <p>h) Kujdeset për implementim të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në programin e studimit, ndjek, mbikëqyr, ndihmon në zhvillimin e orëve të hapura apo seminareve të organizuara nga personeli akademik;</p> <p>i) Mban kontakte dhe ndihmon në organizim të takimeve me biznese si dhe tryeza ad hoc; etj.</p> <p>GVJ konstaton në rolin e koordinatorit është caktuar një pedagoge me gradën Dr, që i realizon detyrat më sipër dhe është e përkushtuar.</p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf</p>
--	---

**Konkluzione:**

GVJ konstaton se Njësia kryesore Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Inzhinierike dhe Detare, përgjegjëse për programin e studimit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

GVJ sugjeron që personeli ndihmës akademik mund të rritet, për të plotësuar më mirë kërkesat e programeve profesionale, në të cilat orët praktike janë shumë të rëndësishme.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>

**Standardi II.3**

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.**

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në DVV, RVB si dhe takimet me drejtuesit e Programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. Të gjitha të dhënat jepen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulloren e programit, ri-aprovuar në 2021, nga Dekani i FPS;</li> <li>• Planin mësimor i cili ka pasur edhe një riorganizim të fundit në vitin 2021. Në dosje është edhe plani paraardhës mësimor;</li> <li>• Syllabuset lëndore, të cilat janë hartuar sipas modeleve të kërkuara nga aktet ligjore, përsa i përket elementeve përbërës;</li> <li>• Rregulloren e praktikës profesionale;</li> <li>• Rregullore e punëve laboratorike;</li> <li>• Udhezime për provimet, etj;</li> </ul> <p><i>Ref: 3_Shkresë MASR_7239-1_17.08.2018_riorg TA.pdf</i>  <i>Ref: 5_Vendim Senati Akad_22_08.04.2019_ndryshim lende.pdf</i>  <i>Ref: 6_Vendim DSID_8_30.04.2018_riorg TA.pdf</i>  <i>Ref: 7_Kerkese Senatit per TA_518_08.06.2018.pdf</i>  <i>Ref: 8_Memo EV_462_25.05.2018_riorg TA.pdf</i>  <i>Ref: 25_C-V pedagog të programit TA - 2023.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore programi TA 2019.pdf</i>  <i>Ref: 50_Shtojca 1 Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf</i>  <i>Ref: 52_Vendim SA + kurrikula TA_19_28.03.2022_riorg 20%.pdf</i>  <i>Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E) TA_2018-2020.pdf</i>  <i>Ref: 57_Ngarkesa totale auditor + kontrolli TA.pdf</i>  <i>Ref: 60_Syllabuset Teknologji Automobilash 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se Plani mësimor është i plotë, me të gjithë informacionin për semestrat, orët mësimore të cdo lënde/moduli, të ndarë sipas formave të mësimdhënies si dhe të ndara në orë mësimore në auditor dhe në orë të punës individuale të studentit. Megjithatë GVJ bën disa sugjerime për rishikimin e tij:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Lënda Praktikë profesionale (I dhe II) është llogaritur me 90 orë në auditor/110 orë punë e pavarur (pra ka më shumë punë të pavarur se punë në auditor (mendojmë se duhet të jetë e kundërta, ku puna e pavarur duhet të synojë 0 orë punë të pavarur, sic është në ndarjen "laboratore). Kjo do të ndihmojë edhe arritjen e kriterit 25% të jenë punë konkrete në profesion (shih më poshtë)</i></li> <li>2. <i>Tek ndarja e orëve në auditor dhe jashtë saj, në ndonjë rast lëndë të ndryshme kanë numer të ndryshëm orësh për të</i></li> </ol>

	<p>njejtën sasi kreditesh të parashikuara, psh: Matematika 4 kredite/leksione 30 orë në auditor (7.5 orë/ 1 kredit) ndërsa Vizatim inxhinierik dhe CAD 4 kredite/ leksione 45 orë në auditor (11 orë /1 kredit)</p> <p>3. Në ndarjen Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave Lëndore në auditor, nga pakujdesia në llogaritje kanë dalë 5 kredite /132 orë, kur në fakt 5 kredite nuk mund të kenë më shumë se 125 orë (1 kredit=25 orë sipas Ligjit të Arsimit të Lartë)</p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf  Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf  Ref: 60_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet e plota për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve jepen në Nenet 22-29 të Rregullores së Programit të studimit. Në RVB deklarohet se: <i>Kriteret e pranimit/përzgjedhjes së studentëve publikohen edhe në faqen elektronike të fakultetit që në muajin Janar, përpara përpara fillimit të procesit të aplikimit dhe janë lehtësisht të aksesueshme. Përpara fillimit të çdo viti akademik UAMD/FSP/DSID udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron nëpërmjet informimit në shkollat e mesme apo në bizneset si dhe në takime të hapura që organizon për të interesuarit dhe studentët e ardhshëm. Në faqen zyrtare të UAMD dhe në portalin U-ALBANIA pasqyrohen rankimet e kandidatëve dhe studentët fitues ku secili student ka fjalëkalimin që shikon në kohë reale renditjen si edhe të dhëna e njoftime të tjera.</i></p> <p>Edhe në takimet me studentët u konfirmua kjo gjë.</p> <p>Ref: 58_Strategji e komunikimit UAMD.pdf  Ref: 59_Manuali_U Albania_2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstaton se, programi i studimit përmban programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara në aktet ligjore.</p> <p>GVJ diskutoi me stafin akademik në takimin përkatës për disa syllabuse, të cilat mendojmë se duhet të jenë pjesë e diskutimeve përmirësuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Në lëndën e <b>Vizatimit Inxhinierik dhe CAD</b>, mendojmë se duhen shtuar edhe tema në lidhje me vizatimin e detaleve/nyjeve; apo leximin e projekteve, pra të shtohet</li> </ul>

	<p><i>afësitë e të lexuarit/ kuptuarit të një projekti dhe jo vizatimi i tyre. Mendojmë se duhen hequr kapitulli i ndërtimeve gjeometrike. Po në këtë lëndë duhet riparë literatura e rekomanduar, që të jetë vetëm nga 5 gjuhët, që ofrohen edhe në shkollat e mesme.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Në Lendën <b>Teknika komunikimi, shkrim akademik</b> duhen shtuar temat e komunikimit. GVJ mendon se në një program 2 vjecar ato janë shumë të rëndësishme, aq më tepër që emërtimi i lëndës e kërkon.</i></li> </ul> <p><i>Ref: 60_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i></p>
--	---

<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësine bazë.</p>	<p>GVJ konstaton se ky program studimi që nga licencimi ka pasur disa rishikime të tij duke e cuar drejt përmirësimit si në përshtatjen me kërkesat e reja ligjore, ashtu edhe të përmirësimit përmbajtësor. Departamenti është kujdesur që cdo vit të krijojë dosjen përkatëse të kurrikulës, me dokumentacionin e plotë.</p> <p><i>Ref: 3_Shkresë MASR_7239-1, 17.08.2018_riorg TA.pdf</i>  <i>Ref: 5_Vendim Senati Akad_22, 08.04.2019_ndryshim lende.pdf</i>  <i>Ref: 6_Vendim DSID_8, 30.04.2018_riorg TA.pdf</i>  <i>Ref: 7_Kerkese Senatit per TA_518, 08.06.2018.pdf</i>  <i>Ref: 8_Memo EV_462, 25.05.2018_riorg TA.pdf</i>  <i>Ref: 50_Shtojca I Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf</i>  <i>Ref: 52_Vendim SA + kurrikula TA_19, 28.03.2022_riorg 20%.pdf</i></p>
---	---

**Konkluzione:**

*GVJ konstaton se Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.*

*Ky program i është nënshtruar rishikimeve/riorganizimeve duke u përmirësuar në përmbajtjen e tij. Departamenti është kujdesur që cdo vit të krijojë dosjen përkatëse të kurrikulës, me dokumentacionin e plotë. GVJ mendon se disa programe lëndore (shih më lart) duhet të jenë pjesë e diskutimeve përmirësuese të mëtejshme.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të**

punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se emërtimi i lëndëve/apo veprimtarive në përgjithësi është në përputhje me përmbajtjen e temave që përmban lënda. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe e praktikave profesionale tendon drejt thellimit të njohurive dhe rritjes së kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve. Pra ka një shpërndarje të natyrshme të ngarkesës.</p> <p><i>Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf</i>  <i>Ref: 60_Syllabuset Teknologji Automobilash 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se tërësia e lëndëve që përbëjnë kurrikulën synon arritjen e objektivave të këtij programi dhe formimin profesional të studentëve sipas rezultateve të pritshme të të nxënit.</p> <p>Shpërndarja është 30 kredite për cdo semestër, ku në semestrin e parë janë vendosur lëndët e tipologjisë A dhe B dhe një lëndë me zgjedhje [C]. Ndërsa më tej vazhdojnë lëndët e tipologjisë B, C dhe D. Të gjitha lëndët/modulet kanë të parashikuar Projekt/Detyrë kursi.</p> <p><i>Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf</i>  <i>Ref: 60_Syllabuset Teknologji Automobilash 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se Raporti teori / praktikë është 50:50, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2 vjecar me karakter profesional. Konkretisht nga Plani i programit rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Orë të formimit në auditor gjithsej . 1245 orë <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Orë të formimit teorik (Leksion+Ushtrime+Projekt/kursi) 622 orë</li> <li>▪ Orë të formimit Praktik (Praktikë prof. + Seminare/Praktikë lëndore+Laboratorë) 623 orë</li> </ul> </li> <li>✓ Orë të provimit përfundimtar .....10 orë</li> </ul> <p><i>GVJ mendon se kriteri që "Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion" nuk është arritur (180 orë për 1245 orë gjithsej arrijnë rreth 15%), por me rritjen e orëve të praktikës (shih sugjerimin më lart) kjo gjë do të rregullohet.</i></p> <p>Nga të dhënat e studentëve rezultojnë disa të pranuar me transferime në këtë program studimi. Gjithashtu studentët dhe zyra e alumni tregojnë për të dhëna shumë të mira të punësimit të studentëve të këtij programi.</p>

		<p>Ref: 55_Plani mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf</p> <p>Ref: 60_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</p> <p>Ref: Tabela 21 - Të dhëna studente nga sekretaria TA +++.pdf</p> <p>Ref: Tabela 23 - Të dhëna punesimi studente-.pdf</p>
<b>Kriteri 5.</b>	Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	<p>Sic është shkruar edhe më lart përditësimi i dosjes kurrikulare është i përvitshëm dhe i dokumentuar. Qëllimi i përditësimit është përputhja me tregun e punës dhe zhvillimet e reja të teknologjisë së automobilave. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse është e pasur. GVJ u interesua në bibliotekë nëse literatura e rekomanduar është pjesë e bibliotekës dhe rezultoi që në të gjitha rastet ato janë në departamet, ose në bibliotekë.</p> <p>Ref: 60_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</p>
<b>Kriteri 6.</b>	Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	<p>GVJ konstaton se bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, është saksionuar në Rregulloren e programit. Mentorimi i praktikës bëhet sipas procedurave të përcaktuara në rregullore, përkatësisht Neni 95 - Mentorimi i studentëve, Neni 96 - Organizimi i mentorimit të studentëve”.</p> <p>Në rregullore, përkatësisht, në Nenin 42 - Zhvillimi i praktikës profesionale dhe në Nenin 46 - Vlerësimi i praktikës profesionale” jepen rregullat e vlerësimit të studentëve në praktikë. Janë paraqitur disa marrëveshje me punëdhënësit, ku studentët bëjnë praktikën.</p> <p>Ref: 27_Rregullore DSID + Vendim SA_69_07.11.2019.pdf,</p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf,</p> <p>Ref: 35_Marreveshje FSP me Adria Ferries_06.2016.pdf</p> <p>Ref: 36_Marreveshje FSP me HSH_2020+2021.pdf</p> <p>Ref: 37_Marreveshje FSP me Shega Trans, 05.2018.pdf</p> <p>Ref: 38_Marreveshje FSP-Auto Star Albania_2017+2022 + Kadiu 2022.pdf</p> <p>Ref: 39_Marreveshje UAMD me Logistic Distribution 30.08.2018.pdf</p>
<b>Kriteri 7.</b>	Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	<p>GVJ konstaton se UAMD vecanërisht është universiteti i parë ku programet e Nivelit të 5 të KSHK janë ofruar me sukses prej themelimit të saj. Edhe programi Teknologji Automobilash hyn në programet e suksesshme profesionale, ku kuotat e pranimit plotësohen gjithmonë dhe kjo reflekton suksesin që ka në tregun e punës. Kompetencat e synuara të të diplomuarve janë: njohuri dhe përgatitje e teknikëve të mjeteve automobilistike, të cilët njohin ndërtimin e automobilave dhe pjesët e tyre përbërëse, mund të bëjnë vlerësimin e tyre nga ana funksionale, bëjnë diagnostikimin e riparimet e defekteve të tyre dhe japin sigurinë e tyre në punë.</p> <p>Ref: 2_Ligj per Kornizen Shqiptare Kualifikimeve 10247/2010.pdf</p>



Ref: 28\_Rregullore programi\_TA 2019.pdf,

**Konkluzione:**

GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin 5 të KSHK dhe KEK.

Rezultatet e të nxënësve, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

GVJ konstaton se Raporti teori / praktikë është 50:50, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program jouniversitar 2 vjecar me karakter profesional.

GVJ mendon se kriteri që "Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion" nuk është arritur (180 orë për 1245 orë gjithsej arrijnë rreth 15%), por me rritjen e orëve të praktikës (shih sugjerimin më lart) kjo gjë do të rregullohet.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>UAMD, FSP dhe DSHID kanë eksperiencë të gjatë në fushën e programeve të studimit, të cilat vazhdimisht janë përmirësuar. Ky program deri aktualisht është rishikuar disa herë. Nga takimet me drejtuesit GVJ konstatoi se UAMD është anëtare në disa projekte me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm (universitete) ku në qendër është cilësia dhe studentët.</p> <p>Për këtë program studimi janë disa marrëveshje me aktorë të tregut të punës, ku krahas kryerjes së praktikave profesionale, ato shërbejnë edhe për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Edhe nga takimi me studentët GVJ konstatoi se janë marrë parasysh propozimet e tyre.</p> <p>Ref: 27_Rregullore DSID + Vendim SA_69, 04.11.2019.pdf, Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf, Ref: 35_Marreveshje FSP me Adria Ferries 26.06.2016.pdf Ref: 36_Marreveshje FSP me HSH_2020+2018.pdf Ref: 37_Marreveshje FSP me Shega Trans, 07.05.2018.pdf Ref: 38_Marreveshje FSP-Auto Star Albania 2017+2022 +Kadiu 2022.pdf Ref: 39_Marreveshje UAMD me Logistic Diamant 30.08.2018</p>

	<i>.pdf</i>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ në takimet me studentët dhe drejtuesit e departamentit u informua se FSP/DSHID ka përfshirë studentët në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit në formën që cdo personel akademik me detyrë mentor, në fund të semestrit mbledh mendime/ sugjerime nga studentët. Këto i parashtron në mbledhjen e posaçme të departamentit. Nga dokumentacioni rezulton se Pedagogu mentor në këtë program studimi është edhe koordinatori i këtij programi. Përfshirja e studentit, si anëtar i GVB është bërë me urdhër të Dekanit, si pjesë e këtij angazhimi. Në kuadër të përmirësimit dhe përfshirjes së studentëve, në DVV është vendosur edhe një rezultat i pyetësorit të zhvilluar në vitin 2018-2019, ku në qendër janë shqetësimi për kënaqësinë e tyre për programin, mjetet laboratorike etj.</p> <p><i>GVJ mendon se duhet të ishte bërë një pyetësor edhe në këtë brez studentësh që studiojnë aktualisht.</i></p> <p><i>Ref: 10_Urdher_Dekani_14, 31.01.2023 GVB per akreditim TA.pdf</i>  <i>Ref:67_Vendim DSHID 07.10.2021_ped mentor.pdf</i>  <i>Ref:75_Rezultate anketimi 2018-2019.pdf</i>  <i>Ref:77_Proced shkrepshkrimit vlersimi nga stud_DSID.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme, në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Gjatë viteve të ofrimit të këtij programi studimi që nga viti 2007, DSHID si njësi përgjegjëse për programin e studimit “Teknologji Automobilahsh” ka punuar për përmirësimin, nëpërmjet përshtatjes me aktet e reja ligjore, përditësimit me lëndë, literaturë të re dhe përshtatjes me tregun e punës. Në këtë veprimtari përmirësuese, janë përfshirë edhe përfaqësues të tregut të punës, profesionistë, etj</p>			
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <p><i>FSP dhe DSHID në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit nxisin përfshirjen e studentëve, atyre alumni si dhe partnerëve. Programi është riorganizuar disa herë dhe GVJ konstaton se këto ndryshime e kanë përmirësuar programin.</i></p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>P</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>P</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

			X	
--	--	--	---	--

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>																	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>																	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>																
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ, bazuar në planin mësimor të përmirësuar 2022-2023, konstaton se në program janë parashikuar orë mësimore në auditor /jashtë auditorit, për elementët e studimit:</p> <table border="0"> <tr> <td>✓ Leksione</td> <td>570 /740 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Ushtime/</td> <td>42/40 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Seminare</td> <td>279/465 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Laboratorë</td> <td>28/0 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Orë për kontrollin e vazhdueshëm</td> <td>132/0 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Praktikë profesionale</td> <td>180/220 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Projekt detyra</td> <td>14/140 orë mësimore</td> </tr> <tr> <td>✓ Provim përfundimtar</td> <td>10/140 orë mësimore</td> </tr> </table> <p>Mendojmë se format e ndryshme të mësimdhënies e rrisin cilësinë e këtij programi. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75-100%.</p> <p>Ref: 55_...ni mesimor + veprimtari (A+E)_TA_2018-2020.pdf  Ref: Tab...1-12_TA_pdf_vule.pdf</p>	✓ Leksione	570 /740 orë mësimore	✓ Ushtime/	42/40 orë mësimore	✓ Seminare	279/465 orë mësimore	✓ Laboratorë	28/0 orë mësimore	✓ Orë për kontrollin e vazhdueshëm	132/0 orë mësimore	✓ Praktikë profesionale	180/220 orë mësimore	✓ Projekt detyra	14/140 orë mësimore	✓ Provim përfundimtar	10/140 orë mësimore
✓ Leksione	570 /740 orë mësimore																
✓ Ushtime/	42/40 orë mësimore																
✓ Seminare	279/465 orë mësimore																
✓ Laboratorë	28/0 orë mësimore																
✓ Orë për kontrollin e vazhdueshëm	132/0 orë mësimore																
✓ Praktikë profesionale	180/220 orë mësimore																
✓ Projekt detyra	14/140 orë mësimore																
✓ Provim përfundimtar	10/140 orë mësimore																

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik dhe ndihmës akademik në përgjithësi i përgjigjen cilësisht nevojave të studentëve. Në syllabuse janë parashikuar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Kjo është e sanksionuar edhe në rregulloren e programit dhe të departamentit. Janë parashikuar konsultimet me studentët për plotësimin e nevojave shtesë të studentëve. Në procesin e mësimdhënies përdoren edhe mjetet audio vizive për seminare të veçanta apo seanca praktike shtesë. Stafi akademik synon në drejtim të asimilimit të informacionit teorik edhe përmes zbatimit të saj në praktikë.</p> <p><i>Ref: 60_Syllabuset_Teknologji_Automobilash_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 27_Rregullore_DSID + Vendim_SA_69, 04.11.2019.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore_programi_TA_2019.pdf</i>  <i>Ref: 68_Orari_i_konsultimeve_DSID + DMT v 2018-2015.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Në DVV janë paraqitur disa marrëveshje shumë të frytshme të Institucionit në ndihmë dhe mbështetje për personelin akademik dhe ndihmës akademik, në rastin e programeve inxhinierike, meqenëse personeli akademik dhe ndihmës akademik ka mangësi në kompetenca didaktike dhe pedagogjike. Për këtë arsye UAMD ka hartuar edhe “Udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies”</p> <p>GVJ konstatoi se për të mundësuar përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, Departamenti /institucioni ka vepruar në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në përmirësimin e infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë, laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies, etj;</li> <li>- Nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme të stafit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies;</li> </ul> <p><i>Megjithatë, GVJ sugjeron që, departamenti duhet të bëjë më shumë përpjekje në trajnimin e stafit inxhinierik me metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe pajisjen me kompetenca në metodat e vlerësimit, metodat e hartimit të pyetjeve të provimeve etj.</i></p> <p><i>Ref: 76 “Udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies”</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>GVJ, mbështetur në CV e personelit akademik, në takimet me anëtarë të tij, si dhe në takimet me studentë konstatoi përgjegjshmëri dhe një staf që punon i angazhuar për dhënien e</p>

<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>njohurive si dhe për zhvillimin e lëndëve me cilësi.</p> <p>Gjithashtu nga syllabuset rezulton se personeli akademik përdor disa forma mësimdhënie. Është pozitiv rregulli i provimit të ndërmjetëm që nxit studentët të jenë më të angazhuar.</p> <p><i>Ref:67_Vendim DSID_1, 07.10.2021_ped mentor.pdf</i>  <i>Ref:75_Rezultate anketimi 2018-2019.pdf</i>  <i>Ref:77_Proced shkresore vlersimi nga stud_DSID.pdf</i>  <i>Ref:. Takime në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Përsa i përket vlerësimit të studentëve është deklaruar në RVB që [cit]: <i>UAMD garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. Në çdo semester dhe për secilin personel akademik me kohë të plotë dhe jo të plotë me studentët e një grupi mësimor të tij realizohet pyetsori, sipas modelit bashkëlidhur këtij Raporti. (Në dosje është vendosur një dokument për pyetsorin e zhvilluar në 2018-2019).</i></p> <p>Gjithashtu është deklaruar se në përfundim të cdo lënde (në fund të semestrit) UAMD mbledh mendime/ sugjerime nga studentët. Rezultatet parashtrihen në mbledhjen e posaçme të departamentit. GVJ mendon se ky proces është pozitiv dhe rrit përgjegjshmërinë e të dy palëve, si pedagogëve por edhe studentëve.</p> <p><i>Ref:67_Vendim DSID_1, 07.10.2021_ped mentor.pdf</i>  <i>Ref:75_Rezultate anketimi 2018-2019.pdf</i>  <i>Ref:77_Proced shkresore vlersimi nga stud_DSID.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura përgjegjëse e UAMD - <b>Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë</b> zhvillon mekanizma të monitorimit (pyetësor/fokus grupe), për të vlerësuar personelin akademik mësimdhënës, ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>Kjo Drejtori ndihmon në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, në bashkëpunim me drejtuesit e FSP e të DSHID për ecurinë e veprimtarisë mësimore dhe përhapjes së “good practice”/përvojës pozitive. Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti);</li> <li>• Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (Bsc/MP/Msc);</li> <li>• Koordinatorët e Programeve (Bsc/MP/Msc);</li> </ul>

	<p>Politika e sigurimit të brendshëm të cilësisë bazohet në:</p> <p>Rregulloren për Sigurimin e Cilesise, ndërsa procedurat shtrihen në të gjithë veprimtarinë menaxheriale dhe akademike.</p> <p>Kualifikimet e personelit akademik që mbulon programin e studimit janë pasqyruar në CV e tyre dhe formularët e kërimit shkencor.</p> <p>Pjesëmarrja në projekte kombëtare e ndërkombëtare, ku përfshihen konferenca me punime shkencore apo prezantime poster, reflekton pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Ref: 44_Rregullore per Sigurimin e Cilesise + VSA_13_21.02.2023.pdf  Ref: 77_Proced shkresore vlersimi nga stud_DSID.pdf  Ref: 78_Formulari VKSH_15.09.2022.pdf  Ref: 79_Botime shkencore - Konferenca - stafi TA - 2023.pdf  Ref: 72_Tabela publikim+ konf + projekte_DSID.pdf  Ref: 73_Raport- Kalendari i aktiviteve-FSP-2021-2022.pdf</p>
--	---

**Konkluzione:**

GVJ konstaton se UAMD/FSP dhe DSHID:

- punojnë për të garantuar cilësi në procesin e të nxënit, nëpërmjet organizimit të mësimdhënies me forma të larmishme të mësimdhënies si Leksione, seminare, ushtrime, laboratorë , detyra, praktikë profesionale, etj. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75-100%.
- aftësimin profesional të personelit akademik që zbaton metodat mësimdhënëse me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve pozitive.
- UAMD ka ngritur struktura përgjegjëse që monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe promovojnë përmirësime të vazhdueshme. DSHID në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë monitorojnë format e mësimdhënies të cilat janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga studentët.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive,	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në:

<p>dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• rregulloren e DSHID, në të cilën përcaktohen rregullat e provimeve, rregullat për ankimimin e notave, etj;</li> <li>• rregulloren e programit të studimit “Teknologji Automobilahsh”;</li> <li>• syllabuset e lëndëve ku në një rubrikë të caktuar ka të detyrueshme edhe mënyrën e vlerësimit të njohurive;</li> <li>• rregulloren e sekretarisë së FSP (që sqarojnë rregullat për regjistrimet në provime, riprovime etj;</li> </ul> <p>Të gjitha rregullat bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>UAMD/FSP mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Ref: 27_Rregulloren DSHID + Vendim SA_69, 04.11.2019.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregulloren programi_TA 2019.pdf</i>  <i>Ref: 80_Rregulloren e sekretarisë FSP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga intervista me studentët, [takim me studentët, takim me stafin akademik] nga RVB si dhe dosja VV, konstatohet se studentët marrin informacione të plota për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset nga titullari i lëndës/modulit. Informimi bëhet në fillim të vitit të parë dhe në fillim të çdo lënde/moduli.</p> <p>Vlerësimi për lëndët mësimore bëhet përmes sistemit të notave nga 5 (note kaluese) deri në 10, ndërsa vlerësimi i provimeve bëhet me sistemin e vlerësimit me 1000 pikë ku vlera përkatëse konvertohet në notë. Nota kaluese më e ulët që është 5 i korrespondon 51% të pikëve të fituara nga studenti. Provimi i parë i ndërmjetëm i theksuar në të gjithë syllabuset zhvillohet në javën e shtatë ose të tetë të semestrit. Detyrat e kursit që zhvillohen gjatë semestrit përmbajnë 100 pikë ose 10% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p><i>Ref: 26_Syllabuset Teknologji Automobilahsh_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 27_Rregulloren DSHID + Vendim SA_69, 04.11.2019.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregulloren programi_TA 2019.pdf</i>  <i>Ref: 80_Rregulloren e sekretarisë FSP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori</p>	<p>Në syllabuset, elementët e të cilit janë të standardizuara jepen format e kontrollit të dijeve. Ato janë të ndryshme.</p> <p><i>FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE: Me shkrim dhe/ose me gojë Provimi i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar me shkrim; mbrojtja e detyrës së kursit me gojë ose me shkrim.</i></p>

ashtu edhe në aftësitë praktike.

Mënyra e vlerësimit është me dy provime, provimi i parë (ka 400 pikë të mundshme) e provimi përfundimtar (ka 500 pikë) dhe detyrat e kursit (duke përfshirë pjesëmarrjen dhe aktivizimin e studentit gjatë gjithë semestrit të cilat kanë 100 pikë të mundshme). Në total studenti/ja mund të përfitojë 1000 pikë të mundshme. Provimi përfundimtar përfshin pyetje nga e gjithë lënda (pyetje për materialin e dhënë gjatë 15 javëve të mësimin). Materiali i provimit përfundimtar do të përfshijë 20% nga materiali i 7 javëve të para të zhvilluara më parë dhe 80% nga materiali i 8 javëve të fundit. Minimumi për të kaluar është 505 pikë.

Një element tjetër i syllabuseve që lidhet me vlerësimin është frekuentimi i studentit.

*FREKUENTIMI: I detyruar*

- Studenti që mungon në 25 % të orëve të lëndës vlerësohet automatikisht me notën 4 dhe duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm.
- Të njëjtës masë ndëshkimore do t'i nënshtrohen edhe studentët që kopjojnë në provim ose që kryejnë plagjaturë duke përvetësuar punën akademike të kolegëve ose të autorëve të ndryshëm të disiplinës në fjalë.
- Korrupsioni aktiv dhe pasiv është i ndaluar dhe ndaj tyre merren masa ekstreme.

GVJ diskutoi edhe me drejtuesit për këtë pjesë të syllabuseve, ku studenti vlerësohet me 4, kur mbush sasinë e mungesave. Përgjigja ishte që platforma dixhitale e sekretarisë e bën automatikisht këtë gjë.

Mendimi i GVJ është që kjo gjë duhet korrigjuar nga administratorët e Sistemit dixhital.

**Konkluzione:**

GVJ konkludon se UAMD/FSP dhe DSHISH kanë hartuar a) rregulloren e programit, b) rregulloren e DSHID, c) rregulloren e sekretarisë, d) rregulloren e zhvillimit të praktikës profesionale si dhe e) syllabuset, ku përcaktohen procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se UAMD garanton zbatimin e tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Sic është shkruar edhe më lart, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës dhe pedagogu/ët. Në çdo lëndë bëhet edhe një kontroll me shkrim i ndërmjetëm, në javën e 7 ose të 8, si edhe një detyrë /projekt që dorëzohet me shkrim ose mbrohet në klasë.</p> <p>Në syllabus është dhënë dhe pesha specifike që ka secili aktivitet vlerësues (400 pk/100pk/500pk/</p> <p><i>Ref: 81_Titullar pedagog-lëndë_TA_2016-2022.pdf</i>  <i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA_2019.pdf</i>  <i>Ref: Ref: 28_Rregullore programi_TA_2019.pdf (Neni 38/39/40)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në RVB theksohet që: UAMD vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. UAMD që nga viti 2018 është pjesë e projektit CleanScore 2016-2018 të Albanian-American Development Foundation (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF). Projekti CleanScore që një nga dy komponentë të tij ka vlerësimin e automatizuar të testeve. Për çdo ankimim mblihet komision që merr vendim.</p> <p><i>Ref: Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga personeli akademik i lëndës ose komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, në ato lëndë që ofrohen nga 2 pedagogë, në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në seksretarinë mësimore GVJ konstatoi këtë në procesverbalet e paraqitura.</p> <p><i>Ref: 81_Titullar pedagog-lëndë_TA_2016-2022.pdf</i>  <i>Ref: 82_Udhezim per provimet_DSID_2018-2019.pdf</i>  <i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA_2019.pdf (Neni 45/48)</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me takime me studentët ku jepen komente dhe këshilla mbi procesin e të nxëniet, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. <b>Për provimin e ndërmjetëm</b>, në javën pasardhëse, personeli akademik i lëndës u komunikon rezultatet studentëve dhe diskuton pyetjet e dhëna në provim. <b>Në provimin përfundimtar</b> brenda 72 orëve u komunikon rezultatet studentëve dhe diskuton pyetjet e dhëna në provim.</p> <p><i>Ref: 82_Udhezim per provimet_DSID_2018-2019.pdf</i>  <i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 39/40)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>GVJ konstatoi që njësitë përgjegjëse kanë treguar seriozitet për plagjiaturën, kopjimin etj. Në cdo syllabus ka një rubrikë “Kodi i etikës” dhe njëkohësisht masat që merren kur ndodhin të tilla probleme [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Të njëjtës masë ndëshkimore do t'i nënshtrohen edhe studentët që kopjojnë në provim ose që kryejnë plagjiaturë duke përvetësuar punën akademike të kolegëve ose të autorëve të ndryshëm të disiplinës në fjalë;</i></li> <li>• <i>Korrupsioni aktiv dhe pasiv është i ndaluar dhe ndaj tyre merren masa ekstreme;</i></li> </ul> <p>Në rregullore theksohet se: Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistent pedagogu apo Komisioni përkatës. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi i cili vlerësohet me 0 pikë. Kur studentit i plotësohet procesverbal për parregullsi në provime, ai nuk lejohet t'a japë lëndën në sezonin e riprovimeve, por duhet t'a frekuentojë përsëri atë.</p> <p><i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 39/40)</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sic është shkruar edhe në Kriterin 4 (më lart), për rezultatet e kontrollit ka përcaktime kohore të dhënies së përgjigjeve. Për provimin e ndërmjetëm, në javën pasardhëse, personeli akademik i lëndës u komunikoi rezultatet studentëve dhe diskuton pyetjet e dhëna në provim. Në provimin përfundimtar brenda 72 orëve u komunikoi rezultatet studentëve dhe diskuton pyetjet e dhëna në provim. Sic është shkruar në kriterin 2, në transparencën dhe meritën në korrigjimet e provimeve shërben edhe CleanScore (shih kriterin 2).</p> <p><i>Ref: 82_Udhezim per provimet_DSID_2018-2019.pdf</i>  <i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 49)</i>  <i>Ref: Formular vleresimi te pedagog nga stud - CleanScore.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD/FSP dhe DSHID, garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 63)</i>  <i>Ref: 26_Rregullore FSP + Vendim SA_35, 20.05.2019.pdf (Neni 53)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në vazhdim të kriterit më lart, GVJ konstatoi se për çdo kërkesë/ankimim ndiqet kjo procedurë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Studenti i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku ai bën pjesë;</li> <li>✓ Dekani, në rast se e gjykon të arsyeshme kërkesën, ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës;</li> <li>✓ Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të grupit mësimor;</li> <li>✓ Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës;</li> <li>✓ Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet;</li> </ul> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 63)</i>  <i>Ref: 26_Rregullore FSP + Vendim SA_35, 20.05.2019.pdf (Neni 53)</i></p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ UAMD/FSP/DSHID sigurojnë vlerësim të drejtë dhe transparent për provimet apo cdo formë mësimdhënie ku bëhet vlerësimi i studentëve.</li> <li>▪ Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti, duke luftuar vjedhjen, plagjaturën, kopjimin.</li> <li>▪ Cdo vlerësim përfshin dhe procesin e ankimit, sipas një procedure të përcaktuar dhe të</li> </ul>	

njohur nga studentët.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			X

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në takimin me studentët GVJ kostaton se kurrikula e programit të studimit “Teknologji Automobilash” garanton marrjen e njohurive në lëndë bazë (matematikë, fizikë), si dhe zhvillimin e aftësive të veçanta për specialistë të fushës së automjeteve në mirëmbajtje, shërbim, riparim, diagnostikim, kontroll e asistencë teknike të automjeteve, kolaudatorë dhe kontrollorë teknik në oficina të ndryshme mekanike, drejtues servisesesh, etj. Fakti që raporti i orëve teorike dhe praktike është 50:50 forcon marrjen e shprehive dhe kompetencave në proceset e mësipërme.  <i>Ref: 50_Shtojca 1 Riorganizim TA 2018 Udh 31.pdf</i> <i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Në kuadër të formimit të profesionistit që duhet të ketë aftësi edhe në fusha si teknologjia, në fushat sociale dhe të komunikimit, GVJ analizoi lëndët dhe syllabuset e tyre. GVJ konstatoi se programi dhe kurrikula e tij garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit.  Syllabuset e lëndëve janë hartuar që përmes detyrave e projekteve të kursit të nxisin bashkëpunimin dhe bashkëveprimin midis studentëve, të mbështesin punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.  <i>Ref: 26_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të	Në fund të vitit akademik trupa e DSHID bën analizën vjetore, ku përmes shifrave analizohet puna e gjithsecilit anëtar për lëndët që mbulon. Gjithashtu në përfundim të çdo lënde, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre në profesion. Në fund të lëndës para provimit përfundimtar Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për

rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	detyrimet përmbyllëse. Këto përfundime GVJ i konstatoi gjatë takimeve me stafin akademik si dhe nga syllabuset e lëndëve. <i>Ref: 83_Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021.pdf</i> <i>Ref: 26_Syllabuset Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia realizohet në kombinim të orëve teorike si dhe orëve praktike, në "Laboratorin e Teknologjise së Automobilave, (në ambientet e FSP), ashtu dhe në praktikat profesionale në qendrat e asistencës teknike, siç janë: "Auto-Star Albania", "Mektrin Motors", ShegaTrans", QKT, etj., duke u aftësuar dhe orientuar drejt teknikut.  Realizimi i praktikave profesionale garantohet nga marrëveshjet bashkëpunuese që UAMD/FSP, ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit. Praktikrat profesionale të zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në formatin përkatës, që shoqërohet me vlerësim.  <i>Ref: 66_Instit+Organiz - praktikat_FSP-TA.pdf</i> <i>Ref: 32_Rregullore Praktike profesionale + V Dekanati_3/2022.pdf</i> <i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 42/46)</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në RVB deklarohet se personeli akademik, efektiv dhe me kontratë i DSHID si strukturë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit "Teknologji Automobilash" zhvillon leksione, orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të teknologjisë dhe shkencës.  Por dokumenti i vendosur në DVV ( <i>84_Leksione te hapura + workshop me studente DSID.pdf</i> ) nuk pasqyron aktivitete për programin që po analizohet		
<b>Konkluzione:</b>  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ GVJ vlerëson se programi i studimit profesional "Teknologji Automobilash" synon të rrisë aftësitë krijuese dhe zbatuese tek studentët dhe veprimtaritë mësimore dhe jashtë auditorit synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ata.</li> <li>▪ Realizimi i praktikave profesionale garantohet nga marrëveshjet bashkëpunuese që UAMD/FSP, ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbylljes së standardit</b>	Nuk përmbyllet	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
			<b>X</b>

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në**

**programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>GVJ konstaton se DSHID ka hartuar procedurë të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit. Kjo procedurë është e përcaktuar në rregulloren e FSP, në rregulloren e programit të cilat janë publike. Sekretaria mësimore përcakton qartë nëse studenti i ka mbyllur të gjithë lëndët e programit të studimit, detyrimet financiare duke i dhënë mundësi atij të hyje në provimin final</p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 43/47)</i> <i>Ref: 26_Rregullore FSP + Vendim SA_35, 20.05.2019.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Kjo del në nenin 43, pika 5 ku është sanksionuar:</p> <p><i>Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të semestrit të dytë, Departamenti u bën të njohur studentëve programet e lëndëve bazë të provimit të përgjithshëm përfundimtar.</i></p> <p>Nga takimi me stafin dhe drejtuesit u konstatua se strukturat përkatëse asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit përfundimtar të diplomimit. Në nenin 47 (pika 3) sanksionohet që:</p> <p><i>Lëndët që do të përfshihen si dhe formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit përcaktohen nga grupi mësimor, kërkimor-shkencor i "Shkencave Inxhinierike"/DSHID sipas specifikave të programit të studimit</i></p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 43/47)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/ viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në nenin 43, (pika 6, dhe 7) flitet për ngritjen e Komisionit të posaçëm për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar:</p> <p><i>Përgjegjësi i DSHID propozon ngritjen e një komisioni për provimin e përgjithshëm përfundimtar i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik. Komisioni i vlerësimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar miratohet nga Dekani i FSP. Komisioni, nëpërmjet sekretarisë mësimore, informon studentët rreth organizimit të provimit për Mbrojtjen e Diplomës.</i></p> <p>Provimi përfundimtar bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë vitit akademik, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Sipas Urdhërit të dekanit nr.16/2021, në provimin përfundimtar përfshihen lëndët</p>

	<p>karakterizuese B dhe lëndët e profilit, që janë në grupun C. Pësia e tyre varet nga sasia e krediteve dhe pedah e lëndës në programin e studimit.</p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (fletë 43/47)</i>  <i>Ref: 85_U Dekan_16, 16.07.2021_proc.prov.diplomimi.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton në programin mësimor si detyrim përmbyllës me 6 ECTS provimin përfundimtar [<i>Evidenca 18. Plani mesimor i programit te studimit</i>].</p> <p>Në planin mësimor janë deklaruar 10 orë në auditor (për konsultime etj)</p> <p>N/A (nuk ka tema diplome)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>N/A (nuk ka tema diplome)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë. Në nenin 47 pika 2 gjejmë:</p> <p><i>Nota përfundimtare llogaritet si mesazhi i të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në programin e studimeve 2-vjeçar me karakter profesional “Teknologji Automobilah” studentit pajiset me “Diplomë profesionale” në “Teknologji Automobilah” nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion Diploma, suplementi i diplomës dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Forma e diplomës është aprovuar nga QSHA në 2019.</p> <p><i>Ref: 51_Diploma+suplementi TA + m... pdf</i>  <i>Ref: 9_Urdher QSHA_123, 05.06.201... identifik + diploma TA.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UAMD përmes sekretarisë mësimore ruan të dhënat në lidhje me studentët. Dosjet personale të tyre arshivohen dhe ruhen. Në lidhje me ecurinë është Regjistrit Themeltar, Regjistrit të Notave dhe i Diplomës. UAMD/FSP ruan për një periudhë të pacaktuar (përgjithmonë) kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>
--	---

**Konkluzione:**

- *GVJ konstaton se UAMD/FSP/DSHID ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.*
- *Në rregullore, urdhëra etj janë të përcaktuara të gjitha hapat për provimin përfundimtar, që nga lëndët që përfshihen, hartimi i tezave, korigjimi i provimeve, procedura e ankimimit etj.*
- *Në përfundim të studimeve studenti pajisjet me Diplomë Profesionale dhe me Suplementin e Diplomës dhe një kopje e plote zyrtare e programit të zhvillimit i vihet në dispozicion.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

**Standardi III.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë në Nenin 6 flitet për pyetësorët e studentëve që vlerësojnë performancën e stafit të angazhuar në mësimdhënie edhe për metodat inovative që ato zhvillojnë. Në RVB deklarohet që: <i>Në strukturën e UAMD ekziston Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Standardeve të Cilësisë (DKSC-ja) që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me NJSBC të fakulteteve dhe njësitë bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, hartojnë udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</i></p> <p>Më tej citohet një dokument <sup>136</sup>EVIDENCA nr. 76 “Udhëzues në nivel institucional për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies”. Ky dokument mungon në dosje.</p>



	<p><i>Ref: 44_Rregullore per Sigurimin e Cilesise + VSA_13/2023.pdf (Neni 6)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga organigrama del se strukturat përgjegjëse që monitorojnë mësimdhënien dhe aftësitë e PA janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC-ja) që është e përbërë nga dy sektorë: <ol style="list-style-type: none"> <li><i>Spektori i çështjeve Mësimore</i> që ndjek mbarëvajtjen e mësimimit dhe në bashkëpunim me Dekanët /departamentet/ koordinatorët e programeve që ofrohen në UAMD me objektiv përmirësimin cilësor të tyre.</li> <li><i>Spektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë</i>, që realizon rishikimin periodik të programeve ekzistuese;</li> </ol> </li> <li>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Fakultetit të Studimeve Profesionale, për realizimin e vetëvlerësimit dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore.</li> </ol> <p>Në modelin e formularit të vetëvlerësimit të stafit akademik janë rubrikat që cdo pedagog vetëvlerëson aftësitë e tij mësimdhënëse, të kërkimit shkencor etj.</p> <p><i>Ref: 43_Organigrama + struktura FSP - 2023.pdf</i>  <i>Ref: 45_Njesia Sigurim Cilesise FSP me V Dekanati _10, 22.04.2021.pdf</i>  <i>Ref: 87_Formular vetvleresimi pedagog.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në RVB është shkruar [cit]: <i>Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</i></p> <p><i>Megjithatë GVJ nuk konstaton të dhëna për publikimin e tyre (në website nuk është publikuar asnjë raport vetëvlerësimi ose analizë vjetore)</i></p> <p>Ndërkohë DASHA (Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike) ka aprovuar një material si strategji komunikimi për të qenë cdo ditë para publikut me të reja për UAMD.</p> <p><i>Ref: 58_Strategji e komunikimit UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në raportet e vlerësimit vjetor GVJ kontaton se ato përshkruajnë praktika të mira, që kuptohet nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Edhe anketimet, mbledhja e përshtypjeve të studentëve në fund të lëndëve, formularët e vetëvlerësimit që plotësohen nga pedagogët i shërbejnë përmirësimin të mësimdhënies.</p> <p><i>Ref: 83_Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021.pdf</i></p>

**Konkluzion:**

- GVJ konstaton se UAMD ndjek një politikë që promovon cilësinë në mësimdhënie.
- Institucioni ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave mësimdhënëse. Gjithashtu nëpërmjet një sërë rregulloresh dhe procedurash bën monitorimin e saj.
- UAMD përmes NJSBC monitoron personelin akademik në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përbushet	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantinimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi				
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ nëpërmjet dokumentave, tabelave dhe takimeve, konstaton se Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik.				
	Në dosje janë dhënë të dhëna për stafin që ka mbuluar programin e studimit që nga 2016-2023, por për 2 vitet e fundit janë këto të dhëna (Referuar Tabelës 12):				
	Stafi akademik për programin e studimit "Teknologji Automobilash"	2021-2022		2022-2023	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	-		-	
	Prof.Ass	-		-	
	Dr/PhD	1		1	
Dr në proces	1		1		
Msc	4	3	4	3	

	<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>3</b>
	<p>GVJ duke analizuar CV e personelit (janë dërguar vetëm CV e personelit akademik efektiv) konstaton se të gjithë kanë të paktën kualifikimin <i>minimal</i> që nevojitet për mbulimin e lëndëve/moduleve të programit profesional 2 vjecar në “Teknologji Automobilah” (sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës). Ato kanë edhe eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> <p><i>Ref: 22_Personeli DSID - te dhena + kualifikim.pdf</i>  <i>Ref: 23_Cilësi stafi për program TA 2016-2023.pdf</i>  <i>Ref: 79_Botime shkencore - Konferenca - stafi TA - 2023.pdf</i>  <i>Ref: 25_C-V pedagog të programit TA - 2023.pdf</i>  <i>Ref: Tabela 12 - Titullar pedagog-lëndë TA 2020-2023.pdf</i></p>				
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ analizoi ngarkesën vjetore të stafit akademik të programit të studimit dhe rezultoi se në një vit mësimor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>6</b> pedagogë (3 PAE dhe 3 PAK) kanë 1 lëndë semestrale (7% secili)</li> <li>• <b>2</b> pedagogë (2 PAE) kanë 2 lëndë semestrale (14% secili)</li> <li>• <b>1</b> pedagog (1 PAE) ka 5 lëndë semestrale (36%)</li> </ul> <p>Pra Personeli akademik (6 të brendshëm, 3 të jashtëm), mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (udhëzimi për ngarkesën mësimore). Në fund të çdo viti akademik bëhet parashikimi i ngarkesës mësimore për vitin e ardhshëm akademik për personelin efektiv, pas dakortësimit në mbledhjen e departamentit</p> <p>Mbështetur në të dhënat e Tabelës 12 (për vitin 2022-2023) rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>6</b> PAE mbulojnë <b>13</b> lëndë dhe <b>1050</b> orë në auditor (<b>84%</b>)</li> <li>• <b>3</b> PAK mbulojnë <b>3</b> lëndë dhe <b>195</b> orë në auditor (<b>16%</b>)</li> </ul> <p><i>Ref. 88_Ngarkesa pedagogeve_Udhezime MASR 29+36+37, 2018.pdf</i>  <i>Ref. 89_Ngarkesa pedagog TA 2019.pdf</i>  <i>Ref: Tabela 12 - Titullar pedagog-lëndë TA 2020-2023.pdf</i>  <i>Ref 29 Marrëveshja parashikimi v 2022-2023.pdf</i></p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke</p>	<p>GVJ konstaton se në periudhën 2016-2023 DSHID ka treguar qëndrueshmëri të personelit akademik. Në 2 vitet e fundit (periudha para procesit të akreditimit) personeli akademik është i njëjtë. Pra Institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për</p>				

<p>përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Ref: 90_Kontrate pune EV 2017.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i bashkëngjitur dhe nga takimi në Zyrën e burimeve njerëzore, GVJ konstaton se UAMD ka përcaktuar politika të qarta të rekrutimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, referuar dhe Statutit dhe Ligjit të AL.</p> <p>Rekrutimi i personelit akademik i nënshtrohet praktikave të përcaktuara përkundërt aplikimit me dosje dhe intervistës së personalizuar me të interesuarit. Vlerësimi i tyre bëhet i njehsuar kundërt kritereve të përcaktuara. Kriteret përcaktohen nga DSHID, mbështetur në nevojat që paraqiten për realizimin e procesit mësimor në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, dhe miratohen nga Rektori. Kandidatët vlerësohen dhe përzgjidhen sipas meritave nga komisioni Ad-hoc i ngritur pranë departamentit. Për vlerësim përdoren “celësat e vlerësimit”, ku janë përcaktuar qartë si duhen vlerësuar mesatarja e notave, studimet doktorale, eksperiencia, gjuha e huaj etj</p> <p><i>Ref. 91_Paketa e BNJ per rekrutim stafi.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga të dhënat (shih Standardi II.2, kriteri 1) rezulton se DSHID ka gjithsej 2 punonjës si personel ndihmës akademik.</p> <p>GVJ <i>sugjeron</i> se mund të shtohet ky numër, nisur nga fakti që DSHID mbulon 8 programe profesionale, ku studentët kanë shumë orë në praktikë profesionale, në laboratorë dhe në këtë rast ndihma e tyre është e domosdoshme. GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh me laboratorët dhe stafin e përfshirë dhe konstatoi gadishmëri nga ana e tyre në ndihmë të studentëve</p> <p><i>Ref: 22_Personeli DSID - te dhena + kualiteti.m.pdf</i> <i>Ref: vizitë në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit</p>	<p>GVJ konstatoi në dokumentacionin e attach-uar në DVV, si dhe në vizitat në institucion se FSP/DSHID mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë të gjithë anëtarët e personelit akademik të programit të studimit, të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me personelin akademik me kohë të</p>

<p>akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ.</p>	<p>plote dhe të pjesshëm. Në takimin e zhvilluar u konstatua se kjo drejtori nuk angazhohet me monitorimin e ngarkesës mësimore, por është përgjegjës për procesin e rekrutimit të personelit të ri akademik në programin mësimor. Në fund të çdo viti akademik personeli përcakton ngarkesën mësimore faktike, e cila miratohet më pas nga përgjegjësi i departamentit të DSHID-së. Ai bën parashikimet në lidhje me ngarkesën mësimore dhe kërkesën për lektorë të ftuar, e cila vijon më pas me miratimet në instancat përkatëse të UAMD-së.</p> <p><i>Ref: 92_Ngarkesa pedagog per prog TA_2022-2016.pdf;</i>  <i>Ref: takim me zyrën e Burimeve Njerëzore</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas rregullores së programit (Neni 6, pika b): <i>Praktika Profesionale për studentët e Departamentit të Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë është programuar të zhvillohet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Për programet 2-vjeçare “Teknologji Automobilah” (...) studentët e vitit të parë i zhvillojnë të shpërndara gjatë semestrit.</i></li> <li>▪ <i>Për programet 2-vjeçare “Teknologji Automobilah” (...) studentët e vitit të dytë i zhvillojnë të grupuara në fund të semestrit të parë apo/dhe të dytë, sipas planit mësimor përkatës.</i></li> </ul> <p>Sipas rregullores (Neni 7, pika 3): <i>PP monitorohet nga pedagogu/ët përkatës të Praktikës Profesionale</i></p> <p>Sipas rregullores (Neni 9, pika 2) <i>Vlerësimi i studentëve që realizojnë Praktikën Profesionale bëhet me mbrojtjen e Relacionit të praktikës, në fund të semestrit.</i></p> <p>UAMD/FSP/DSHID, në marrëveshje dhe bashkëpunim me biznese e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. GVJ konstaton se në Nenin 31, pika 9 e Rregullores së programit të studimit shkruhet [cit]: <i>Praktika profesionale (...) zhvillohet në 2 dy ditë të javës gjatë semestrit ose me ditë të grupuara. Studentit që po kryen Praktikën Profesionale nuk i vendosen mungesa në lëndët e tjera (!) që zhvillon pjesa tjetër e studentëve të atij seksioni/ grupi mësimor.</i></p> <p><i>GVJ mendon se kjo pikë dëmton cilësinë e lëndës, ku studenti mund të mungojë dhe deklarohet se “njëkohësisht po frekuenton një/disa lëndë të tjera”. Duhet korigjuar në rregullore kjo pikë që të mos ketë keqkuptime/keqinterpretime.</i></p>

	<p>Ref: 32_Rregullore Praktike profesionale + V Dekanati_3/2022.pdf</p> <p>Ref: 35_Marreveshje FSP me Adria Ferris 26.06.2016.pdf</p> <p>Ref: 36_Marreveshje FSP me HSH_2020+2018.pdf</p> <p>Ref: 37_Marreveshje FSP me Shega Trans, 07.05.2018.pdf</p> <p>Ref: 38_Marreveshje FSP-Auto Star Albania 2017+2022+Kadiu 2022.pdf</p> <p>Ref: 39_Marreveshje UAMD me Logistic Diamant 30.08.2018.pdf</p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në dokumentin 40_Udhezues praktike + anexet + V Dekanati_2, 15.03.2019.pdf, konstatohet se janë aprovuar dhe standardizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Modeli i “RELACIONI PRAKTIKËS PROFESIONALE”</li> <li>✓ Autorizimi që lëshon dekani kur grupi/studentët bëjnë praktika ditore</li> <li>✓ Vërtetimi për kryerjen e praktikës profesionale që lëshon Personi përgjegjës</li> </ul> <p>Nga marrëveshjet e nënshkruara dalin detyrimet e palëve. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Psh në marrëveshjen me Shëga Trans GVJ shkruhet se <i>Shoqëria Shega Trans angazhohet në atashimin e studentëve praktikantë pranë specialistëve duke mundësuar praktikimin nën mbikqyrjen e tyre.</i></p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf  Ref: 40_Udhezues praktike + anexet + V Dekanati_2, 15.03.2019.pdf,  Ref: 67_Vendim DSHID_1, 07.10.2021_ped mentor.pdf</p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• GVJ vlerëson që Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit profesional “Teknologji Automobilash”, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</li> <li>• Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në UAMD bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.</li> <li>• GVJ konstatoi se FSP/DSHID mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.</li> </ul>	

- Personeli në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		Përmbushet	
	gjithësisht	kryesisht	gjithësisht	kryesisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe proframi 2 vjecar “Teknologji Automobilah” ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike/laboratorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Nga vizita në këtë institucion dhe dokumentacioni në DVV, rezulton se :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Mjediset e FSP në funksion të mësimdhënies (16 salla leksionesh, 12 laboratore , 1 bibliotekë , 3 zyra informimi, 1 mjedis shlodhës , 4 nyje hidrosanitare ).....5678 m<sup>2</sup></li> <li>✓ Mjediset për stafin (zyra, etj).....794 m<sup>2</sup></li> <li>✓ Normativa (5 m<sup>2</sup>/student) - ..... mbi 5 m<sup>2</sup>/st</li> </ul> <p>Një rregullore për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuara, tregohet edhe për masat që merren në raste të tilla në infrastrukturë.</p> <p>Ref: 93_Planimetri + kapac. infrastr Currila + Kampus 1 - 2022.pdf            Ref: 94_VKM 418, 10.05.2017 Standarte infrastruk, kriteret per stud.pdf            Ref: 96_Tabela laborator-prog studimi.pdf            Ref: Tabela 16 - Ambientet e FSP ++.pdf            Ref: 120_Rregullore - trajtim stud. me aftesi te kufizuar.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes</p>	<p>GVJ vizitoi kabinetet dhe auditorët, ku zhvillojnë mësim studentët e programit dhe konstatoi se është bërë punë e mirë për t'i pajisur me stenda dhe video-projektor, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët. Laboratorët janë ndërtuar në shërbim të këtij programi dhe i kanë të gjithë</p>

<p>përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>pajisjet, aparaturat zhvillimin e mësimdhënies në lëndët përkatëse</p> <p><i>Ref: 84_Leksione te hapura + ëorshop me studente DSID.pdf</i>  <i>Ref: 96_Tabela laborator-prog studimi.pdf</i>  <i>Ref: Tabela 16 - Ambientet e FSP ++.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ vizitoi kabinetet Laboratorin e Teknologjisë së Automobilave dhe Laboratorin Elektrik dhe laboratorët e tjerë që përdoren nga studentët e këtij programi profesional, dhe konstatoi se (nga Tabela 96), për këtë program studimi janë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Laboratori i Automobilave (i shërben edhe 4 programeve te tjera)</li> <li>✓ Laboratori i Elektrik (i shërben edhe 4 programeve te tjera)</li> <li>✓ Laboratori i Fizikës (i shërben të gjitha PS të FSP që zhvillojnë lëndën e Fizikës)</li> </ul> <p>Laboratorët janë ndërtuar në shërbim të këtij programi dhe i kanë të gjithë pajisjet, aparaturat zhvillimin e mësimdhënies në lëndët përkatëse.</p> <p><i>Ref: 95_Studimet prof + lab TA + foto.pdf</i>  <i>Ref: 96_Tabela laborator-prog studimi.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstaton se FSP ka lidhur marrëveshje me FTI për shfrytëzimin e laboratorit të TI, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programeve të studimit që ofron.</p> <p>Gjithashtu Laboratori HUB i TI është realizuar përmes projektit “Erasmus+CBHE” “Përshpejtimi i Modernizimit të Universitetit në Ballkanin Perëndimor përmes Teknologjisë Virtuale” (Accelerating western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies–VTech) në të cilën UAMD është lider projekti prej 11 partnerësh.</p> <p>Duke përfshirë Teknologjitë Virtuale në kulturën akademike, UAMD/FSP synojnë të përmirësojnë cilësinë në mësimdhënie dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mëtejshëm të shoqërisë digjitale në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor.</p> <p><i>Ref: 97_Marreveshje FSP dhe FTI_21.04.2020.pdf</i>  <i>Ref: 98. Rreg HUB tek virtuale-VSA 11, 09.02.2022.pdf</i></p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• GVJ vlerëson që UAMD-Fakulteti i Studimeve Profesionale, kanë vënë në dispozicion të programit të studimit “Teknologji Automobilash” mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik, të posaçëm për natyrën inxhinierike të automobilave, etj. Aktiviteti mësimor zhvillohet në ambientet e</li> </ul>	



ndërtesës e vendosur ne zonën e Currilave

- Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse (fizike dhe elektronike), e vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe, në anglisht dhe në ndonjë rast edhe në gjuhën maqedone.</p> <p>Kjo literaturë është vendosur edhe në syllabuset përkatëse nga personeli akademik. Literatura e rekomanduar synon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit “Teknologji Automobilah”.</p> <p>Për arsye të vështirësive të hartimit të teksteve shkollore për lëndët, një pjesë e konsiderueshme e lëndëve mbulohet nga literatura e përgatitur nga vetë stafi, në formën e cikleve të leksioneve, në përputhje me temat në syllabuset përkatëse. Këto materiale janë vënë në dispozicion studentëve në librarinë e fakultetit, si dhe në variantin elektronik në ueb-site <a href="http://www.kataloguonline.uamd.al">http://www.kataloguonline.uamd.al</a>.</p> <p>Kopjet fizike të leksioneve të lëndëve të këtij programi studimi depozitohen në DSHID dhe në Bibliotekën e UAMD.</p> <p>Ref: <a href="http://www.kataloguonline.uamd.al">http://www.kataloguonline.uamd.al</a> (Leksionet elektronikisht në veb-site)</p> <p>Ref: 61_Tekstet si literature baze+rekom_DSID_2019.pdf</p> <p>Ref: 62_Tabela e libra+lex ne Departament_2021.pdf</p> <p>Ref: 101_Manual - Biblioteka Online.pdf</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e vendosur në katin e parë të godines në zonën e Currilave, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Nga dokumenti ‘info për Bibliotekën UAMD’ dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se qëllimet, objektivat dhe parimet e bibliotekës janë në funksion të programeve të studimit,</p>

	<p>studentëve, personelit akademik, kërkimit shkencor , dhe mund të përmbliidhen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Efektiviteti institucional</i></li> <li>2. <i>Vlerat profesionale</i></li> <li>3. <i>Roli edukativ</i></li> <li>4. <i>Zbulimi</i></li> <li>5. <i>Koleksionet</i></li> <li>6. <i>Hapësirat</i></li> <li>7. <i>Menaxhimi/administrimi</i></li> <li>8. <i>Personeli</i></li> <li>9. <i>Marrëdhëniet me jashtë</i></li> </ol> <p>Biblioteka funksionon mbi bazën e një rregullore dhe ka në shërbim të saj edhe dy biblioteka përkatësisht në Godinën 1 dhe në Kampus</p> <p><i>Ref: 99_Rregullorja e Bibliotekes.pdf</i>  <i>Ref: 100_Info per biblioteken UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumenti ne referencë rezulton se Biblioteka e UAMD është e pasur në numër të konsiderueshëm botimesh të viteve të fundit. Kontigjenti i librave ka ardhur nga blerjet, dhurimet nga IAL, Shtëpi botuese, etj, si edhe nga projektet të ndryshme (IZUM- përfshirja në rrjetin COBISS, akses falas në U-LIBRARY, lidhja me BK, Lidhja me kompaninë Koral INC, etj). Ajo është e pajisur me literaturë fizike si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhë të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e lëndëve mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit “Teknologji Automobilah”. Cdo vit, leksionet e përgatitura nga pedagogët, të cilat i vihen në dispozicion studentëve, kanë edhe një kopje në bibliotekë (hardcopy dhe në formë dixhitale). <i>Ref: 100_Info per biblioteken UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit “Teknologji Automobilah”. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. Biblioteka e UAMD është pjesë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>&gt; platformën KOHA (databaze elektronike e krijuar nga vetë UAMD)</li> <li>&gt; platformën COBISS: <a href="https://www.cobiss.net/al/">https://www.cobiss.net/al/</a></li> </ul>

	<p>&gt; <a href="http://plus.al.cobiss.net/opac7bib/search?db=udu">http://plus.al.cobiss.net/opac7bib/search?db=udu</a></p> <p>&gt; në U-LIBRARY</p> <p>&gt; në JSTOR deri në vitin 2023.</p> <p><i>Ref: 101_Manual - Biblioteka Online.pdf</i>  <i>Ref: 102_Lista e paketave U-Library.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi që ajo është e pajisur me kompjutera, softuere dhe me pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin për të gjithë studentët.</p> <p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Salla me fond të hapur është komode dhe në shërbim të plotw të studentëve, personelit akademik etj, çdo ditë të javës nga ora 8.00-16.00</p> <p><i>Ref: 103_Grafik -Biblioteka funksionon dhe ne fundjave.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD synon përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programeve të studimit. Në mënyrë sistematike kërkohet nga pedagogët që leksionet, librat apo botime të depozitohen një kopje në bibliotekë dhe në departament. Në mënyrë të përvitshme, nëpërmjet plan buxhetit kërkohen titujt e librave apo botimeve specifike për çdo program studimi.</p> <p><i>Ref: 104_Biblioteka_Praktika per librat, Vënera.pdf</i>  <i>Ref: 61_Tekstet si literature baze+rekom_DSID_2019.pdf</i>  <i>Ref: 62_Tabela e libra+lex ne Departament_2021.pdf</i></p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>GVJ konstaton se Programi i studimit përmban literaturën e nevojshme të detyruar dhe të rekomanduar. Ajo është në mbështetje të mësimdhënies.</i></li> <li>• <i>UAMD ka ndërtuar edhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën, mjedisë të posaçme, shlodhëse dhe rekreative.</i></li> <li>• <i>GVJ konstaton që UAMD ndjek një procedure të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar</i></li> </ul>	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në sekretari, GVJ u informua që institucioni ka sistemin e menaxhimit 'Pitagora', nëpërmjet të cilit administron të dhënat/ database për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Të dhënat janë të sigurta dhe kanë përdorim sipas statusit/ autorizimit (student, pedagog, punonjës i sekretarisë.</p> <p>FSP/DSID disponojnë statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, nëpërmjet sekretarive mësimore.</p> <p>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Bazuar edhe në Statut (neni 92), UAMD mban në forme të shkruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rregjistrin themeltar të studenteve;</li> <li>Rregjistrin e arritjeve akademike;</li> <li>Rregjistrimin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave;</li> </ol> <p>GVJ verifikoi edhe pajisjen e studentëve me numër matkulimi siç përcaktohet qarte edhe në nenin 92 në Statut të UAMD-së.</p> <p>Ref: 105_Rregullore DASHA sektori komunikim, ALUMNI.pdf  Ref: 106_Të dhëna studentë FSP 2016-2022 nga sekretaria.pdf  Ref: 107_Platforma sekretarise ESSE3 RASH.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e</p>	<p>Nga takimet në Institucion dhe nga DVV konstatojmë se sistemi i brendshëm i menaxhimit 'Pitagora' administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ etj. Ky sistem ndihmon në veprimtarinë e tyre akademike apo administrative dhe lehtëson procedurat e regjistrimit, regjistrimeve në provime, nxjerrjen e notave, dhënien e vërtetimeve, etj.</p> <p>Ref: 108_Rregullore e Keshillit të botimeve VSA 43-1,</p>

programit.	14.06.2018.pdf
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Pitagora siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. Sistemi i menaxhimit <i>nuk</i> ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p>Sekretaria mësimore menaxhon dhe koordinon sistemin duke bërë edhe verifikimet në lidhje me përmbushjen nga ana e pedagogoet për çdo student të rubrikavë të ofruara nga platforma, ndërsa janë bërë edhe verifikimet në lidhje me kryerjen e pagesës së tarifës studentore nga ana e studentëve përpara hyrjes së tyre në provime</p> <p>Shkëmbim informacioni bëhet në classroom ose përmes email-it ku stafi akademik dërgon skriptet dhe materiale shtesë që janë përdorur gjatë leksioneve apo seminareve.</p> <p><i>Ref: 109_Strategji e komunikimit UAMD.pdf</i>  <i>Ref: 110_Strategji TIK 2020-2025.pdf</i>  <i>Ref: 111_Posteri pedagog+student Pitagora.pdf</i>  <i>Ref: takim në institucion, vizitë në Sekretarinë Mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit <i>nuk</i> garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, apo raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>Akcesi në sistemin Pitagora mundësohet nëpërmjet faqes web të UAMD-së ku propozohet hyrja e dedikuar e studentëve/stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarisë mësimore të hedhë online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse</p> <p>Në mënyrë të veçantë në kushtet e pandemisë, u shfrytëzua gjerësisht platforma Google Classroom nëpërmjet të cilës postoheshin edhe materialet për çdo temë mësimore si dhe Google Meet për të mundësuar komunikimin online</p> <p><i>Ref: 112_Rregullore e menaxh.aktiviteteve kerk.shkencore.pdf</i>  <i>Ref: 113_Rregullore e Keshillit te kerkim shkencor.pdf</i>  <i>Ref: 114_Rregullore baza e te dhenave te kerkim shkencor.pdf;</i>  <i>Ref: takim në institucion, vizitë në Sekretarinë Mësimore. takim me stafin akademik; takim me studentët</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Faqja zyrtare e UAMD është <a href="http://www.uamd.al">www.uamd.al</a></p> <p>Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në këtë faqe, në dy gjuhë shqip dhe anglisht.</p>
---	--

**Konkluzione:**

- *GVJ konstaton se UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional "Pitagora" që menaxhon dhe administron dhe bën monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.*
- *Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.*
- *Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjene studentëve**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në nenin 38 në Statut të UAMD-së, njësitë bazë dhe njësitë kryesore hartojnë projektbuxhetin mbështetur edhe në planin strategjik të zhvillimit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij. Universiteti "Aleksandër Moisiu" harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Nga RVB, dhe DVV, GVJ konstaton se ky raport financiar ka llogaritjet e kostove deri në Njësitë kryesore, në rastin e programit -FSP.</p> <p><i>Ref: 115_Raport financiar - UAMD - v.2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet</p>	<p>GVJ konstaton se plani i financimit të njësisë kryesore-Fakultetit të Studimeve profesionale përmban financimin në drejtim të pagave të stafëve të programeve, orët suplementare (deri në 300 orë), në blerjen e materialeve utilitare, për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e</p>

<p>operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>literaturës e aksesin në bibliotekat online, etj.</p> <p>Në dokumentacionin e hartuar për riorganizimin e programit të studimit “Teknologji Automobilah” jepen edhe llogaritja e kostos/ për 1 student, ku përfshihen financimi i burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p> <p><i>Ref: 115_Raport financiar - UAMD - v 2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 116_PBA per FSP 2021-2022.pdf</i>  <i>Ref: 41_Politikat hapje, riorg program stud + Vendim SA 15/2021.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se sic e kërkojnë aktet ligjore, UAMD kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Bazuar në Statutin e UMAD-së, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm është përgjegjëse për të ushtruar kontrole dhe hartuar raporte mbi veprimtarinë financiare dhe administrative të universitetit [neni 34 Statut të UAMD-së].</p> <p><i>Ref: 118_Karta e Auditimit te brendshem UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në përfundim të vitit financiar DSHID raporton në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet dhe përmbushjen e objektivave financiare. Cdo vit bëhet raportim për veprimtarinë e FSP dhe DSHID, lidhur me kostot financiare të programin e studimit “Teknologji Automobilah”, apo planifikimet për vitin pasardhës.</p> <p><i>Ref” [takime në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se ky program plotëson ose është afër kuotave të planifikuara të studentëve dhe kjo gjë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, duke qenë se të ardhurat kryesore vijnë nga tarifat e studimit.</p> <p>Në të ardhmen gjenerimi i të ardhurave nga veprimtari me të tretë, është i domosdoshme.</p> <p><i>Ref” [takime në institucion]</i></p>

**Konkluzione:**

- GVJ vlerëson se UAMD/FSP garantojnë financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit “Teknologji Automobilash” dhe mbështetjen e studentëve.
- Institucioni cdo vit harton një raport financiar të kostove të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit.
- Institucioni ka kryer auditimin periodik, duke vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, ndërsa UAMD si institucion Publik është subjekt kontrolli të jashtëm nga institucionet financiare shtetërore

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushjet pjesësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushjet pjesësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

**V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE****Standardi V.1**

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>UAMD/FSP/DSHID kanë hartuar Strategjitë e zhvillimit dhe kuadrin ligjor si Rregullore, Udhëzime, procedura, të cilat zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti: informimin, pranimin, përparimin, transferimin/njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimin e dijeve/ankimimin dhe në fund diplomimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e UAMD.</p> <p>Një zyrë e vecantë kujdeset edhe për studentët pas diplomimit.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e UAMD-së zhvillohet në përputhje me rregulloret, udhëzimet.</p> <p>Ref: 15_Plani i zhvillimit strategjik UAMD 2020-2025.pdf            Ref: 16. Strategji nderkombetarizimi UAMD 2022-2024.pdf            Ref: 17 Statuti UAMD + Urdher MASR_385, 09.07.2019.pdf</p>



	<p>Ref: 18_Rregullore UAMD + Vendim SA_154, 26.11.2018.pdf  Ref: 19_Strategjia Komb_Punesim_Aftesi 2014-2020.pdf  Ref: 58_Strategji e komunikimit UAMD.pdf  Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf  Ref: 26_Rregullore FSP + Vendim SA_35, 20.05.2019.pdf  Ref: 27_Rregullore DSID + Vendim SA_69, 04.11.2019.pdf  Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf  Ref: 32_Rregullore Praktike profesionale + V Dekanati_3, 31.01.2022.pdf  Ref: 44_Rregullore per Sigurimin e Cilesise + VSA_13, 21.02.2023.pdf  Ref: 80_Rregullorja e sekretarisë FSP 2022.pdf, etj  Ref: 59_Manuali_U Albania_2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat në hyrje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, sepse bëhen nëpërmjet Maturës shtetërore dhe U-albania që është ngritur mbi politikën meritë-preferencë të kandidatëve për studentë.</p> <p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, të ndjekura nga Fakulteti i Studimeve Profesionale, janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ato kanë garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta EDHE për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit “Teknologji Automobilash”.</p> <p>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 24, 26, 38-43, 45-49)  Ref: 59_Manuali_U Albania_2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se në muajin Qershor përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron, nëpërmjet informimit në shkollat e mesme apo në bizneset. Komunikimi është nëpërmjet uebsite, rrjeteve sociale etj. Kjo bëhet nëpërmjet një strategjie të mirëmenduar të komunikimit.</p> <p>Ref: 119_Praktika shkresore MAS-UAMD-FSP kritere studente.pdf  Ref: 58_Strategji e komunikimit UAMD.pdf;  Ref: Takime në institucion  Ref: 59_Manuali_U Albania_2021.pdf</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe</p>	<p>GVJ konstaton se në të gjitha strategjitë, rregulloret ku përfshihen kriteret/procedurat e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë shkruar në gjithë të kuptueshme për studentin apo prindin dhe janë të</p>

të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

publikuara në faqen elektronike të Fakultetit. Ato janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe publiku. Gjithashtu cdo procedurë (regjistrim, njohje/ekuivalentim, vlerësim me notë, etj) ka edhe procedurën e ankimit, kur personi nuk mbetet i kënaqur me to.

Në fillim të çdo viti akademik UAMD dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar. Procedura e pranimit bëhet sipas udhëzimit të MASR.

Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave është përcaktuar qartë në Nenin 74 në Statutin e UAMD-së dhe në rregulloret përkatëse. UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ u njoh me procedura transferimi dhe verifikoi procedurat e transferimit/ç'regjistrimit dhe konstatoi zbatim të rregullt.

Programi i studimit	Viti akademik	Studentë të c'regjistruar
Teknologji Automobilash	2021-2022	0
	2022-2023	1

Ref: 28\_Rregullore programi\_TA 2019.pdf

Ref: vizitë në sekretarinë mësimore.

Ref: 80\_Rregullorja e sekretarisë FSP 2022.pdf

**Kriteri 5.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.

GVJ konstaton se UAMD si Universitet Publik i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta, ose për disa kategori të veçanta. Institucioni ka hartuar një *Rregullore për trajtimin e studentëve me aftësi ndryshe*. Në lidhje me të UAMD aplikon dhënie të bursës shtetërore për kategoritë e përcaktuara në VKM dhe në politikat shtetërore si dhe në bazë të rezultateve akademike (neni 8).

**Kriteri 6.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në nenin 11 [cit]: *UAMD merr masa progresive të zbatimit të kërkesave të aksesueshmërisë së studentëve me aftësi të kufizuar të intelektit, duke përshtatur në përputhje me nevojat e tyre cdo informacion në internet për ta apo për konsumim publik*

Në këtë rregullore ka edhe nene që mbështesin financimin studentëve në masa të ndryshme. UAMD ka politika edhe ndaj shtresave të marginalizuara.

Ref: 120\_Rregullore - trajtim stud. me aftesi te kufizuar.pdf

Ref: 59\_Manuali\_U Albania\_2021.pdf

**Konkluzione:**

- GVJ vlerëson se UAMD/FSP dhe DSHID kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.
- GVJ vlerëson si shumë të dobishme strategjitë e komunikimit, që sjell informimin e të interesuarve dhe transparencë.
- UAMD si Universiteti Publik i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta ose për disa kategori të veçanta.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët, janë të njohur dhe të qartë, lidhur me kriteret në përparimin akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe kriteret për kalimin në cdo lëndë.</p> <p>Në javën e parë që quhet edhe 'java e orientimit', studentët informohen me rregullat e përgjithshme të funksionimit të Universitetit, programit të studimit, lëndëve, sekretarisë, etj.</p> <p>Informacioni që FSP/DSHID, apo koordinatori i cdo programi i vë në dispozicion të studentëve është i plotë, i qartë dhe që siguron barazinë në trajtimin e tyre.</p> <p>Informacioni jepet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• publikimit të rregulloreve, njohjes së studentëve me syllabuset, etj. në faqen web: <a href="https://uamd.edu.al/kalendari-akademik/">https://uamd.edu.al/kalendari-akademik/</a>; <a href="https://uamd.edu.al/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/">https://uamd.edu.al/departamenti-i-teknologjise-se-informacionit/</a>; <a href="https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2022/11/SPE.pdf">https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2022/11/SPE.pdf</a>];</li> <li>• Broshurave dhe fletpalosjeve të institucionit që i korrespondojnë jetës studentore, ku jepet informacion i rëndësishëm në lidhje me programin [përmbajtja e kurrikulës, orari mësimor, personeli akademik etj</li> <li>• Punës informuese të stafit akademik, i cili bazuar edhe</li> </ul>

	<p>në detyrat dhe përgjegjësitë e tij i komunikon çdo informacion tek studenti, presanton syllabusin në fillim të vitit akademik, ndihmon në përgatitjen e studentit duke ndjekur progresin e tij dhe bën vlerësimin bazuar në përcaktimet ligjore të shprehur në Rregulloren e Programit të Studimit</p> <p><i>Ref: 121 "Java e orientimit të studentëve"</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloret e FSP, DSHID dhe të programit të studimit ka edhe kriteret/procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p> <p>Për studentët që rregjistrohen si program i dytë ose transferohen në programin "Teknologji Automobilash", komisioni ad-hoc bën njohjen e krediteve të fituara dhe ekuivalentimin e lëndëve.</p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf</i> <i>Ref: 80_Rregullorja e sekretarisë FSP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se në syllabuset/Programet lëndore, si dhe në :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Statutin e UAMD-së - Kreu VII "Organizimi i studimeve";</li> <li>• Rregulloren e UMAD-së – Kreu III "Organizimi i studimeve", Kreu VI "Të drejtat dhe detyrat e studentëve dhe organizimet studentore";</li> <li>• Rregulloren e FSP-së- Kreu III "Organizimi i Studimeve";</li> <li>• Rregulloren e Programit të Studimit – Kreu II (neni 14-22), Kreu III "Vlerësimi i studentit" (neni 23-27), Kreu IV "Pranimi i studentëve" (neni 29-30);</li> </ul> <p>janë vendosur qartë rregullat e vlerësimit, mënyrat e vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar. Gjithashtu janë përcaktuar edhe rregullat për frekuentimin dhe sanksionet që ka një student, kur tejkalon mungesat (25%) në pjesëmarrjen në mësim.</p> <p>Në syllabuse janë dhënë të qarta edhe vlerësimi i aktivizimit të studentit gjatë semestrit, prezantimi/ mbrojtja e detyrës së kursit apo rregullat e provimit përfundimtar. Këto rregulla të përshkruara më lart u prezantohen dhe shpjegohen studentëve nga personeli akademik në orën e parë të zhvillimit të lëndës. Gjithashtu edhe rregullat e përgjithshme të funksionimit të Universitetit qartësohen nga personeli akademik për të gjithë në orën e parë të prezantimit.</p> <p><i>Ref: 60_Syllabuset_Teknologji Automobilash_2021-2022.pdf</i> <i>Ref: 121 "Java e orientimit të studentëve"</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD/FSP/DSHID ndjekin një procedurë të</p>

<p>me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit. Në rregullore, urdhëra etj janë të përcaktuara të gjitha hapat për provimin përfundimtar, që nga lëndët që përfshihen, hartimi i tezave, korigjimi i provimeve, procedura e ankimimit etj.</p> <p>Së pari kjo del në nenin 43, pika 5 ku është sanksionuar:</p> <p><i>Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të semestrit të dytë, Departamenti u bën të njohur studentëve programet e lëndëve bazë të provimit të përgjithshëm përfundimtar.</i></p> <p>Nga takimi me stafin dhe drejtuesit u konstatua se strukturat përkatëse asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit përfundimtar të diplomimit. Në nenin 47 (pika 3) sanksionohet që:</p> <p><i>Lëndët që do të përfshihen si dhe formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit përcaktohen nga grupi mësues, kërkimor-shkencor i "Shkencave Inxhinierike"/DSHID sipas specifikave të programit të studimit</i></p> <p>Provimi përfundimtar bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë vitit akademik, duke përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Sipas Urdhërit të dekanit nr.16/2021, në provimin përfundimtar përfshihen lëndët karakterizuese B dhe lëndët e profilit, që janë në grupun C. Pësha e tyre varet nga sasia e krediteve dhe pedah e lëndës në programin e studimit.</p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (Neni 43/47)</i>  <i>Ref: 85_U Dekan_16, 16.07.2021_proc.prov.diplomim.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>GVJ konstaton se studentët, janë të njohur dhe të qartë, lidhur me programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në javën e parë që quhet edhe 'java e orientimit', studentët informohen me rregullat e përgjithshme të funksionimit të Universitetit, programit të studimit, lëndëve, sekretarisë, etj.</p> <p><i>Ref: 109_Strategji e komunikimit UAMD.pdf</i></p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>GVJ vlerëson se UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i></li> <li>• <i>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UAMD publikon udhëzues të</i></li> </ul>	

posaçëm dhe FSP/DSHID organizojnë takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.

- Faqja zyrtare web është burim i rëndësishëm informacioni të nevojshëm në lidhje me programin mësimor. Institucioni informon studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosjeve dhe fushatave të informimit.
- Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore, në drejtim të rregullave për frekuentimin, kalimin në vitet pasardhëse, etj

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga takimi me Studentët GVJ konstatoi se ato informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit “Teknologji Automobilash”. Informacioni në lidhje me programin e studimit “Teknologji Automobilash” është detyrë e koordinatorit të programit, pedagogëve të cdo lënde, Qendrës së Komunikimit, Karrierës &amp; Alumni si edhe sekretarisë mësimore.</p> <p>Informacioni mundësohet edhe përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë nëpërmjet faqes online të DSHID/ FSP/UAMD.</p> <p>Në sistemin elektronik të faqes zyrtare të UAMD/FSP jepet edhe informacion mbi kurrikulat dhe lëndët e programit.</p> <p>GVJ konstatoi se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët është edhe platforma Google Meet/Classroom duke mundësuar postimin e materialeve për çdo temë mësimore si dhe për të mundësuar komunikimin online.</p> <p><i>Ref: 28_Rregullore programi_TA 2019.pdf (neni 21/27/30)</i> <i>Ref: Takime në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt</p>	<p>UAMD ka në strukturën e saj organike Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, përfaqësuesit e së cilës i takoi edhe GVJ. Kjo zyrë ka varësinë nga Drejtoria e Administrimit dhe</p>

<p>dhe në tregun e punës.</p>	<p>Shërbimeve Akademike dhe ka për detyrë të informojë studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p> <p>GVJ zhvilloi një takim të veçantë me këtë zyrë dhe u njoh me punën e organizuar në lidhje me punësimin e studentëve.</p> <p><i>Ref: Rregullore e sektorit të komunikimit, Alumnit dhe karrierës.pdf</i></p> <p><i>Ref: nr. 122 "Udhëzues nga zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Aplikojmë për punë, 2020" (mungon në dosje DVV)</i></p> <p><i>Ref: nr. 123 "Shoqata ALUNMI e studentëve të UAMD" (mungon në dosje DVV)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p>Hapësirat funksionale të përdorshme në funksion të programit të studimit "Teknologji Automobilash" janë sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët, zyrat funksionale, hapsirat kreative etj.</p> <p>Në ambiente kishte edhe orientime (shenja) për lëvizjen. Godina e Currilave është e pajisur edhe me ashensor për të mundur një akses sa më të lehtë të lëvizjes së studentëve në kate, veçanërisht për studentët me aftësi të veçanta</p> <p><i>Ref: 94_VKM 418, 10.05.2017 Standarte infrastruk, kritere per stud.pdf</i></p> <p><i>Ref: vizitë në institucion</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Në kuadër të realizimit të praktikave profesionale, FSP/DSHID informojnë studentët mbi oraret, kompanitë/partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohet ajo, rregullorja e zhvillimit, e vlerësimit të punës në praktikë, etj.</p> <p><i>Ref: 32_Rregullore Praktike profesionale+V Dekanati_3, 31.01.2022.pdf</i></p> <p><i>Ref: 40_Udhëzues praktike + anexet + V Dekanati_2, 15.03.2019.pdf</i></p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>GVJ vlerëson se UAMD ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i></li> <li>• <i>Gjithashtu DSHID informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen.</i></li> </ul>	

- *Infrastruktura është e pajisur me shenjat përkatëse të orientimit*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
			X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi																												
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Programi i studimit “Teknologji Automobilah” është ofruar nga FSP për herë të parë në vitin 2007-2008.</p> <p>FSP/DSHID, nëpërmjet sekretarive mësimore, dhe Sektorit të Teknologjisë së Informacionit (IT) disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar, të regjistruar në programin 2-vjeçar të studimeve, c’regjistrimet/ largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Nga të dhënat që disponon sekretaria del se:</p> <p>Studentë të regjistruar /c’regjistruar sipas viteve:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>2016-2017</th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>50 (1)</td> <td>50 (0)</td> <td>43 (5)</td> <td>41 (1)</td> <td>55 (1)</td> <td>59 (0)</td> <td>69 (1)</td> </tr> </tbody> </table> <p>Studentë të diplomuar sipas viteve:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>2016-2017</th> <th>2017-2018</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>32</td> <td>34</td> <td>31</td> <td>34</td> <td>27</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Në takime u theksua edhe roli i Sektorit të Komunikimit, Karrierës &amp; Alumni në lidhje me mbajtjen e statistikave për studentet e diplomuar dhe gjurmimin e tyre.</p> <p><i>Ref: 106_Të dhëna studentë FSP 2016-2022 nga sekretaria.pdf</i></p>	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	50 (1)	50 (0)	43 (5)	41 (1)	55 (1)	59 (0)	69 (1)	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	32	34	31	34	27		
2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023																							
50 (1)	50 (0)	43 (5)	41 (1)	55 (1)	59 (0)	69 (1)																							
2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023																							
32	34	31	34	27																									
<p><b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Platforma Pitagora ndihmon në lidhje me vlerësimet e stafit akademik për çdo provim, frekuentimet dhe detyrimet e studentëve.</p> <p>Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për këtë</p>																												



	<p>program studimi janë hedhur të dhënat në dy format.</p> <p><i>Ref: vizitë në institucion.</i></p> <p><i>Ref: Tërësia e të dhënave në DVV</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.).</p> <p>Në bazë të rregullores së Sekretarisë mësimore është kryesekretari që kontrollon të dhënat dhe cdo dokument që menaxhohet në sekretari (Neni 6).</p> <p>Pasqyrimi i të dhënave për studentët e regjistruar në Regjistrat Bazë dhe në Regjistrin e Arritjeve Akademike sanksionohet në Nenin 28. Puna e sekretarisë kontrollohet nga zv/dekani i FSP.</p> <p>Sekretaria mësimore dhe Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike që ka në varësinë e saj Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, në të cilën angazhohen 3 specialistë kanë në fokus kryesor mirë administrimin e çdo database që lidhet me sistemet e informacionit dhe IT-së dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse Aktiviteti i këtyre dy sektoreve është subjekt kontrolli të vazhdueshëm nga Rektorati dhe për FSP nga Zv/Dekani për procesin mësimor.</p> <p><i>Ref: 80_Rregullorja e sekretarisë FSP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>DSHID/FSP/UAMD hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre.</p> <p>Nga raportet e vëzhguara del se ato analizojnë të gjithë elementët që ndihmojnë apo pengojnë procesin e mësimdhënies. Në raporte reflektohen edhe problematikat nga gjetjet e NJSBC-së përmes anketimeve të kryera me studentët për përmbajtjen e programit mësimor, vlerësimin për personelin akademik dhe infrastrukturën. Raportet shoqërohen edhe me rekomandimet përkatëse në lidhje me përmirësimet e duhura</p> <p><i>Ref: 83_Raporti vjetor DSID_2019-2020-2021.pdf</i></p>
<p><b><u>Konkluzione:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>GVJ konstaton struktura të ngritura Brenda Institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve.</i></li> <li>• <i>GVJ vlerëson se UAMD/FSP dhe DSHID nëpërmjet këtyre strukturave mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin</i></li> </ul>	

e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

- Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Dekanati/Rektorati.
- DSHID/FSP/UAMD hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përbushet sërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p> <p>Këshillat e studentëve (Neni 90 në Statutin e UAMD) janë organizime të pavarura të studentëve të UAMD-së, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të UAMD-së në të gjitha programet e studimit. Sipas udhëzimeve edhe GVB për çdo program studimi në kuadër të akreditimit të tyre përfshijnë anëtarë -studentë.</p> <p><i>Ref: 17_Statuti UAMD + Urdher MASR_385, 09.07.2019.pdf (Neni 90)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UAMD/FSP kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj.</p> <p>Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në Bord dhe në Senatin akademik.</p> <p><i>Ref: nr. 127 "Fituesit e studentëve në Këshillat studentorë" (mungojnë në dosje DVV)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe</p>	<p>Në përmirësimin e programit të studimit, DSHID ka realizuar diskutime dhe ka kërkuar sugjerime për: ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit "Teknologji Automobilitash", parashikimin e procedurave joburokratike të</p>

reflektton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.

përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.

GVJ konstaton se programi i studimit ka pësuar ndryshime që nuk tejkalojnë masën 20% në përmbajtje. FSP/DSID ka përfshirë studentët në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve lëndore, duke reflektuar sugjerimet e tyre. Këto sugjerime merren në mbledhje të përbashkëta në departament, ose me pyetësorë, ose me grupe fokusimi.

GVJ mësoi gjatë takimeve se cdo pedagog në fund të lëndës semestrale mbledh mendime dhe sugjerime nga studentët dhe i parashtron në mbledhjen e posaçme të departamentit.

*Ref: nr. 128 "Pyetsor i hartuar nga DHSID për marrjen e mendimeve të studentëve lidhur me përmirësimit të programit të studimit" (mungojnë në dosje DVV)*

*Ref: 10\_Urdher Dekan\_14, 31.01.2023 GVB per akreditim TA.pdf*

*Ref: 28\_Rregullore programi\_TA 2019.pdf*

*Ref: vizitë në institucion.*

**Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/ pedagogut përgjegjës.

GVJ konstaton se studentëve u kërkohet mendim mbi procesin e vlerësimit të dijeve, barazinë apo ndershmërinë e këtij procesi, duke përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e FSP/DSHID/personelit akademik përgjegjës.

Studentëve u njihet e drejta e ankimimit e cila shprehet qartë në Statut dhe në Rregulloren e UMAD-së, FSP dhe programit të studimit. Programi i studimit ka edhe Koordinatorin e tij i cili mban kontakte të vazhdueshme me studentët dhe përcjell shqetësimet e këtyre të fundit në Njësinë Bazë dhe në Dekanat.

Secili pedagog mentor organizon takime me studentët e grupit mësimor, të cilat gjithashtu i përcjell në DSHID dhe FSP.

*Ref: vizitë në institucion.*

**Konkluzione:**

- *GVJ vlerëson se UAMD/FSP/DSHID përfshijnë dhe angazhojnë studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese.*
- *GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në bord dhe në Senatin akademik*
- *Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.*

**Shkalla e përmbushjes së**

Përmbushet  
pjesësisht

Përmbushet  
kryesisht

Përmbushet  
plotësisht

standardit			X
------------	--	--	---

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se në organigramën e UAMD ka njësi të posaçme, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sektori i Komunikimit Alumni dhe Karrieres;</li> <li>• Sektori i Çështjeve Mesimore;</li> <li>• Sekretaria mësimore, etj;</li> <li>• Sektori Pagesave të Studenteve;</li> </ul> <p>në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të saj. Këto njësi kanë procedura gjithëvjetrore në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre.</p> <p><i>Ref: 42_Organiograma + struktura analitike e UAMD.pdf</i>  <i>Ref: 43_Organiograma + struktura FSP - 2023.pdf</i>  <i>Ref: 105_Rregullore DASH, Sektori komunikim, ALUMNI.pdf</i>  <i>Ref: 80_Rregullorja e sekretarisë FSP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga organigrama dhe nga RVB kontatojme se Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në varësi të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike është struktura përgjegjëse që zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë.</p> <p>Por në sistemin e informimit ndihmon edhe koordinatori i programit, i cili jep ndihmë lidhur me ndjekjen e ecures së studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë. [Evidenca 23. Rregullorja e programit, neni 10].</p> <p>Gjithasht sic është theksuar edhe më lart pjesë e punës informuese janë edhe mentorët, faqja e internetit, etj</p> <p><i>Ref: 42_Organiograma + struktura analitike e UAMD.pdf</i>  <i>Ref: 105_Rregullore DASH, Sektori komunikim, ALUMNI.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të</p>	<p>GVJ në takimin me përfaqësues të zyrës 'Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës' u informua se kjo zyrë zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni, dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumnit,organizon</p>

<p>posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e.</p> <p>Spektori për Komunikimin, Karrieren &amp; Alumni u ofron studentëve një numër shërbimesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Ndjekje dhe organizim i çështjeve të karrierës së studentëve;</i></li> <li>- <i>Organizimin e panairit të Punës ku studentët kanë mundësi të njihen me kompanitë dhe kërkesat e tyre në lidhje me punësimin;</i></li> <li>- <i>Kurse trajnimi mbi hartimin e CV, procedurat së intervistës etj.</i></li> <li>- <i>Seminare të hapura ku përfaqësues të biznesit ftohen të japin eksperiencën e tyre;</i></li> <li>- <i>Këshillime dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve;</i></li> <li>- <i>Bashkëpunon ngushtë me departamentet e fakulteteve për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve;</i></li> <li>- <i>Mban kontakte me alumni dhe bën gjurmimin e punësimit të tyre;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Spektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës kishte të dhëna për punësimet pas diplomimit sepse mendohej të mbante lidhje me ish studentët. Gjithashtu kjo zyrë është struktura përgjegjëse që harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore.</p> <p>Edhe DSHID ndihmon në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>Nga takimi me studentët u konstatua se ato ishin shumë optimistë për punësimin e tyre, sepse rrjeti alumni ndihmon. Një pjesë e tyre dëshironin të vetëpunësoheshin.</p> <p><i>Ref: nr. 122 "Udhëzues nga zyra e Komunikimit, Alumni dhe Karrierës për punë, Aplikojmë për punë, 2020" (mungojnë në dosje DVV)</i></p> <p><i>Ref: nr. 130 "Informacion për studentët e trajnuar nga Spektori i Komunikimit, Alumni dhe Karrierës" (mungojnë në dosje DVV)</i></p> <p><i>Ref: nr. 131 "Databaze e punësimit të alumni" (mungojnë në dosje DVV)</i></p>
<p><b>Konkluzione:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>GVJ vlerëson se UAMD ka procedura e njësi të posaçme (Spektori i Çështjeve Mesimore; Sekretaria mësimore; Spektori Pagesave të Studenteve) për pritjen, orientimin, këshillimin e</i></li> </ul>	

studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave.

- Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.
- Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X

### Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknologji Automobilash”

#### a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Nevojat e larta të tregut të punës në ekonominë e Shqipërisë për specialist të fushës së shërbimit të automjeteve, sepse transporti rrugor dhe mjetet e transportit zenë vendin kryesor. Kërkesa të larta për këto specialistë, që përgatiten në programe të tilla studimi profesionale 2 vjecare ka gjithashtu edhe tregu ndërkombëtar;
2. Politikat informuese të UAMD që udhëzojnë publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron sjellin kërkesë të lartë për studime në këtë program studimi. Gjithashtu kostot më të ulta të studimeve dhe fakti që punësimi i menjëhershëm i tyre është në përqindje shumë të lartë, gjithashtu sjellin kërkesa të larta dhe plotësimin e kuotave për këtë program studimi;
3. Ngarkesa mësimore mbulohet kryesisht nga stafi akademik me kualifikimin e duhur, për të garantuar cilësinë e mësimdhënies. Ai është i motivuar si në drejtim të ruajtjes së cilësisë, por edhe të përmirësimit profesional dhe pedagogjik të tyre, për të rritur cilësinë e përgatitjes së studentëve;
4. Infrastruktura mësimdhënëse është në funksion të organizimit me cilësi të mësimin. Sallat e leksioneve, Biblioteka/ salla e leximit, laborator i Teknologjisë së Automobilave dhe Servisi për automjete, ofrojnë kushte optimale në zhvillimin e praktikave profesionale e orëve laboratorike;
5. Organizimi dhe menaxhimi i programit të studimit përmes planit mësimor, syllabuseve të lëndëve ndarjes së ngarkesës mësimore, ku sigurohet raporti teori/ praktikë në 50%:50%, pra

i orëve për leksione/përkundrejt orëve për praktikë profesionale, orë laboratorike, detyra kursi, projekte të zhvilluara nga studentët;

6. Kujdesi i vazhdueshëm nga Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detare/Fakulteti i Studimeve Profesionale për të sistemuar dokumentacionin e plotë të programit të studimit, sistemi efektiv i regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave për studentët, programet, pedagogët;

**b. Pika të dobta:**

1. Disa programe lëndore (shih më lart në raport) duhet të jenë pjesë e diskutimeve përmirësuese të mëtejshme, si literatura, tematika, orët në auditor - në lëndën e praktikën profesionale, etj; *[Standarti 1.2, Kriteri 1]; [Standarti 2.2, Kriteri 3]; [Standarti 2.3, Kriteri 2]; [Standarti 2.3, Kriteri 4]; [Standarti 2.4, Kriteri 3]*
2. GVJ sheh dobësi në bashkëpunimin ndër-departamentor. Temat në syllabuset e ndonjë lënde të formimit bazë nuk janë përshtatur sa duhet me këtë program studimi; *[Standarti 1.2, Kriteri 1].*
3. Nuk ka ndonjë raport analitik të vecantë, të përfitimeve nga marrëveshjet e nëshkuara (një pjesë prej tyre kanë nevojë të rinovohen) *[Standarti 1.2, Kriteri 3]*
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale nuk shprehet për Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi në Shqipëri/Europë, në faktin që 70% e programeve duhet të jenë të njejta. Është shprehur për to vetëm në analizën përfundimtare të RVB, ku këto programe të IAL-ve të tjera i quan rrezik dhe pengesë konkurruese. *[Standarti 2.1, Kriteri 6]*

**Rekomandime**

1. DSHID (Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detare) të përmirësojë disa syllabuse të lëndëve, që të jenë më të përshtatshme/ përputhshme me kurrikulën e programit të studimit dhe objektivave të saj;
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit mund të zgjerohen edhe me qendrat e shërbimit të automjeteve, ku ish studentët (alumni) janë punësuar aktualisht, ose me qendra të tjera që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale;
3. GVJ, sugjeron që të realizohen analiza periodike në formën e raporteve të shkruara, ku të analizohet më me hollësi se çfarë shkoi mire dhe çfarëduhet të përmirësohet në bashkëpunimet që ndihmojnë në realizimin e praktikave profesionale;
4. Mendojmë se FSP (Fakulteti i Studimeve Profesionale) duhet të shprehet për Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi në Shqipëri/Europë. Gjithashtu sugjerohet të rishihen edhe programet lëndore të tyre, për të përafuar kurrikulën dhe për të realizuar kriterin 70% të njejta;
5. Mendojmë se me 10 programe studimi që ofron DSHID (1 Bsc/1 MP/8 PP) dhe me numrin total të studentëve që është i konsiderueshëm, duhet të jetë më imadh numri i Personelit

Ndihmës Akademik, shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punëve në departament, organizimin e laboratorëve, etj;

6. Të punohet për të rritur mobilitetet e studentëve, në bashkëpunim me koncesionarët e automjeteve që janë në partneritet me kompanitë e mëdha europiane të prodhimit të automjeteve;

### **Evaluation's conclusions for the professional study program in "Auto Technology"**

#### **a. Strengths and affirmations:**

1. In the economy of Albania road transport and means occupy the main place, therefore the need of labor market for specialist in Auto service is high. There is also an increasing demand in the international market for specialists graduated in such professional 2 – years study programs;
2. UAMD's information policies that guide the public and interested parties regarding the general and specific admission requirements and criteria of the study program ensure high demand of students to enroll in this study program. On the other hand the low study fee and high employment rate of students raise the demand and are indicators of quota fulfillment in this study program;
3. The teaching load is mainly covered by academic staff (full/part time) with the appropriate qualification, to guarantee the quality of teaching. The academic staff is motivated both in terms of maintaining quality and improving professional and teaching requirements in order to ensure the quality of students' knowledge;
4. The teaching infrastructure is in function of qualitative teaching lessons. The lecture halls, the Library/reading room, the Automobile Technology laboratory and the Vehicle Service provide optimal conditions for the development of professional practices and laboratory classes;
5. Good organization and management of the study program through the curricula plan, course syllabuses, division of the teaching load by ensuring the theory/practice ratio to 50%:50%, i.e. of hours for lectures/versus hours for professional practice, laboratory hours, course assignments, projects developed by students;
6. Continuous attention by the Department of Engineering and Marine Sciences/Faculty of Professional Studies to systematize the entire documentation of the study program and maintaining the effective system of registration and data storage for students, programs, lecturers;

#### **b. Weaknesses:**

1. Some subject programs (see above in the report) should be part of further improvement discussions, such as literature, topics, hours in the auditorium - in the subject of



- professional practice, etc [*Standart 1.2, Criteria 1*]; [*Standart 2.2, Criteria 3*]; [*Standart 2.3, Criteria 2*]; [*Standart 2.3, Criteria 4*]; [*Standart 2.4, Criteria 3*]
2. GVJ sees weaknesses in inter-departmental cooperation. The topics in the syllabus of any basic education courses are not sufficiently adapted to this study program [*Standart 1.2, Criteria 1*]
  3. There is no special analytical report of the benefits from the signed agreements (some of them need to be renewed) [*Standart 1.2, Criteria 3*]
  4. The Faculty of Professional Studies does not comment in the fact that 70% of the programs must be the same with similar programs with professional character offered in the same field of study in Albania/Europe. We define an expression of them only in the SWOT analysis of SER, where these programs from other HEIs are considered as risky and competitive barrier [*Standart 2.1, Criteria 6*]

### **Recommendation**

1. DENSc (Department of Engineering and Naval Science) should improve the contents of some syllabus in order to be more appropriate/ compliance with the curriculum of the study program and its objectives;
2. Cooperation agreements can also be extended with vehicle service centers, where former students (alumni) are currently employed, or with other centers that help in carrying out professional;
3. EEG (External Evaluation Group) suggests that periodic analyzes be carried out in the form of written reports, where detailed analysis on what went well and what needs to be improved in the agreements that contributes in the implementation of professional practices should be provided;
4. We consider that the FPS (Faculty of Professional Studies) should be expressed about the study programs with a professional character, which are offered in the same field of study in Albania/Europe. It is also suggested to review their subject programs in order to align the curriculum and achieve the 70% same criterion;
5. EEG think that with 10 study programs offered by this department (1 Bsc/1 PM/8 PP) and with the total number of students being considerable, the number of Academic Support Personnel should be increased as a very important factor in providing assistance and running the work in the department, organizing the laboratories hours, etc;
6. The Department need to work toward establishing cooperation with vehicle concessionaires that are in partnership with large European vehicle manufacturing companies in order to increase student's mobility;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X